



# ANALIZA E SITUATËS SË PËRGJEGJËSISË SOCIALE TË KORPORATAVE

në Shqipëri

Praktikat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse

**Analiza e Situatës së Përgjegjësive Sociale të Korporatave në Shqipëri**  
*Praktikat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse*

.....

Ky botim u mbështet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri dhe Ambasada e Kanadasë në Shqipëri.

[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ambasada e Kanadasë në Shqipëri, 2013

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali i përfshirë në këtë botim mund të citohet apo riprintohet lirisht, mjafton që t'i jepen meritat dhe t'i dërgohet një kopje e botimit që përmban materialin e riprintuar Prezencës së OSBE-së dhe Ambasadës së Kanadasë në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, përfshi këtu, por jo vetëm, përdorimin komercial apo zhvillimin e raporteve të tjera, duhet të ketë lejen e shkruar të Prezencës së OSBE-së dhe Ambasadës së Kanadasë në Shqipëri.

*Përgatitur nga:* Irena Gribizi, Ilir Rrëmbeci  
*Konsulent:* Louis Guay  
*Redaktuar nga:* Elton Qëndro  
*Përkthyer nga:* Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
*Projektimi dhe radhitja:* ALBDESIGN

ISBN 978-92-9235-245-5

*Mohim: Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pozicionin e Prezencës së OSBE-së ose Ambasadës së Kanadasë në Shqipëri.*

## PARATHËNIE

Është për tu vlerësuar vizioni largpamës i brëndatrupëzuar në këtë dokument si dhe të gjithë ata që janë përfshirë në këtë punim të rëndësishëm: autorët, konsulentët institucionet mbështetëse, pjesëmarrësit e korporatave dhe të qeverisë si dhe redaktorët. Sidoqoftë, kjo përpjekje për të dhënë një panoramë shumë të dobishme së situatës aktuale të Përgjegjesisë Sociale së Korporatave në Shqipëri nuk është fundi. Ky është thjesht hapi i parë, një piketë drejt një procesi mjaft më të gjatë. Dhe do të shërbejë si bazë për hapat e radhës.

Në fakt, procesi që ju keni nisur është aq i gjatë saqë duhet të jetë i përhershëm. Ky proces duhet të ketë për qëllim përdorimin e parimeve të Përgjegjesisë Sociale, vlerave, standardeve, kuadrit dhe mjeteve të saj, me fjalë të tjera një kuadër i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale për të transformuar zhvillimin e burimeve natyrore të Shqipërisë në produkte dhe përfitime të qëndrueshme për të gjithë.

Një kuadër i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale kërkon që aktorët pjesëmarrës në ekuacionin socio-ekonomik apo në projekte ekonomike të mëdha (d.m.th. qeveritë, investitorët dhe komunitetet) të ndajnë përgjegjësi specifike dhe të përbashkëta për funksionimin e sistemit. Ky sistem i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale ka për qëllim krijimin e ekuilibrit të përfitimeve të cilat duhet t'i korrespondojnë kategorive të ndryshme të aktorëve ndërmjet morisë së ndërveprimeve që ato kanë me njëri-tjetrin.

Ekuilibri mund të vijë vetëm si rezultat i këtyre ndërveprimeve.

Një sistem i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale nuk është ai që bazohet në një kuadër ku nuk fiton asnjëri. Sistem i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale është ai që krijon mundësi me anë të sinergjive që krijon apo që ndihmon të identifikohen.

Synimi përfundimtar është qëndrueshmëria apo rezultatet e qëndrueshme dhe përfitime për të gjithë.

Përgjegjësia Sociale vlen për qëndrueshmërinë ose jetëgjatësinë njësoj siç vlen stërvitja në sport: një tipar i pashmangshëm dhe tërësor i performancës.

Një sistem i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale është ai ku ndodhin një mori ndërveprimesh ndërmjet kategorive të ndryshme të aktorëve (qeveritë, investitorët dhe komunitetet) duke krijuar kështu, ndër të tjera, një partneritet të efektshëm. Partneritetet e efektshme të të gjitha llojeve (formale, informale, vertikale, horizontale, të përkohshme, të përhershme, fitimprurëse, jofitimprurëse, etj.) ndërmjet kategorive të ndryshme të aktorëve, janë një parakusht për të pasur rezultate të qëndrueshme dhe jetëgjata.

Raporti e trajton gjerësisht këtë aspekt të Përgjegjesisë Sociale. Ai ofron një panoramë të procesit të institucionalizimit (p.sh., krijimi i një Rrjeti Kompakt Global të OKB-së dhe një Forumi me Shumë Aktorë për CSR-në si dhe një listë të aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga këto institucione ose nga të cilat ato janë krijuar) si një tregues i rëndësishëm i ecurisë në frontin CSR në Shqipëri.

Ky raport është një panoramë me rezolucion të lartë dhe kënd të gjerë të situatës e cila ofron plot mundësi dhe sfida të vlefshme. Shqipëria mund të shërbejë si model për tu ndjekur.

Një këshillë e fundit: Ruani qëndrueshmërinë e interesit dhe rregullshmërinë e përpjekjes tuaj!

*Louis Guay  
Profesor/Ekspert, Universiteti Saint Paul, Otava  
Mars 2013*



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR) është shndërruar në një fenomen global dhe baza e të dhënave për CSR-në, *Regjistri i Korporatave*, ka regjistruar 5.736 raporte qëndrueshmërie ose CSR-je, të cilat janë botuar në më shumë se 100 vende në vitin 2010. Aktualisht, CSR-ja po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në botën e biznesit, dhe e njëjta gjë vlen edhe për në Shqipëri, veçanërisht për industrinë nxjerrëse.

Si vijim i iniciativës për diskutime mbi CSR-në në tryezat e mëparshme të rumbullakëta të organizuara nga Ambasada Kanadeze në Shqipëri dhe në kuadër të punës së Prezencës së OSBE-së në çështjet e mirëqeverisjes, promovimit të metodave pjesëmarrëse në mekanizmin e planifikimit lokal, promovimin e pjesëmarrjes publike sipas Konventën Aarhus dhe punës për promovimin e transparencës dhe çështjeve të anti-korrupsionit, të dyja këto organizata organizuan një seminar të nivelit të lartë në 19 shkurt 2013. Ky aktivitet solli përvojën më të mirë kanadeze për zbatimin e praktikave të përgjegjësive sociale dhe mjedisore, dhe i ofroi qeverisë, OJQ-ve dhe anëtarëve të komunitetit mundësinë për të kuptuar më mirë konceptin e CSR-së falë përvojës kanadeze, si dhe u dha mundësinë të shohin se cilat programe mund të transferohen në kontekstin shqiptar.

Megjithatë që të kishin një panoramë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të situatës aktuale së praktikave të CSR-së në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri së bashku me Ambasadën Kanadeze në Shqipëri e konsideruan si thelbësore kryerjen e një studimi mbi praktikën ekzistuese të CSR-së në industrinë nxjerrëse.

Studimi u krye nga dy konsulentë vendas gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2012, dhe u përqendrua në tetë kompanitë kryesore ndërkombëtare dhe vendase që kryejnë aktivitetin e tyre në katër sektorët kryesorë nxjerrës: nafta & gazi, minierat, prodhimi i çimentos dhe hidrocentralet. Konsulentët bashkëpunuan ngushtë me kompanitë e përzgjedhura nga industrinë nxjerrëse, ministrinë e linjës, njësitë e qeverisjes lokale, OJQ-të, si dhe nga projektet e donatorëve në vend.

Detyrat e caktuara u përmbushën duke ndjekur metodologjinë e punës si më poshtë: kryerja e studimit, hartimi i pyetësorëve, përgatitja e një formulari për të intervistuarit, organizimi i intervistave individuale, mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e raporteve.

Ky studim tregoi se është mjaft e qartë se Shqipëria ka bërë hapat e parë drejt përvetësimit të praktikave të CSR-së. Duke qenë se Shqipëria është pjesë e proceseve që lidhen me globalizimin dhe integrimin në BE, CSR-ja merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Për më tepër, zbatimi i standardeve të CSR-së shërben si një mjet për të krijuar përparësi konkurruese për bizneset shqiptare, si ato rajonale ashtu edhe ato që veprojnë në tregun evropian, dhe ka për qëllim krijimin e një imazhi më të mirë për kompanitë, menaxhimin e riskut dhe vlera të shtuara. Gjithashtu, ky raport sjell praktikën më të mira, si për shembull *Titan Group*, *Shkolla Profesionale të Thumanës*, apo *Bankers Petroleum Albania Ltd*, *Iniciativa për Mbështetjen e Bujqësisë*.

Pavarësisht sfidave aktuale për zbatimin e legjislacionit mbi CSR-në, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është angazhuar të promovojë standardet sociale dhe mjedisore si një burim shtesë për konkurrueshmëri dhe rritje të qëndrueshme për kompanitë shqiptare në tregun vendas dhe atë global. PNUD-i po promovon axhendën e CSR-së mes aktorëve lokalë në Shqipëri.

Arritjet më të rëndësishme deri tani janë: krijimi i Rrjetit të Kombeve të Bashkuara për Kompaktin Global, zhvillimi i një dokumenti politikash mbi CSR-në, adoptimi i Kodit për Qeverisjen e Korporatave për kompanitë e palistuara, hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për CSR-në dhe treguesit përkatës, krijimi i Forumit të Aktorëve Shumëpalësh, përshtatja e standardeve ISO 26000, trajnimi i gazetarëve të medias lokale dhe projekte për dhënien e çmimeve për CSR-në.

Konsulentët kryen një sërë vizitash në terren dhe organizuan takime me përfaqësues të biznesit nga sektorët e industrive nxjerrëse, si dhe me aktorët e interesuar dhe OJQ-të. Çështjet kryesore të mbuluara gjatë intervistave përfshijnë: 1) Histori e shkurtër dhe aktiviteti i kompanisë, 2) Ndikimi i CSR-së dhe arritjet në lidhje me stafin, komunitetin dhe mjedisin, 3) Bashkëpunimi me Njësitë e Qeverisjes Lokale, 4) Problemet me të cilat përballen, dhe 5) Planet për të ardhmen.

Zbulimet treguan se thuajse të gjitha kompanitë janë përgjegjëse për tre shtylla kryesore të politikës dhe veprimeve të CSR-së, si për shembull stafi/punonjësit, komuniteti/shoqëria dhe mjedisi. Disa nga kompanitë reagojnë më shumë në lidhje me fusha specifike në krahasim me kompanitë e tjera, por në përgjithësi, të gjitha i trajtojnë çështjet që lidhen me CSR-në. Zakonisht kompanitë kanadeze që veprojnë në Shqipëri i kanë përfshirë praktikën e CSR-në në strategjinë e tyre të zhvillimit duke u bazuar në praktikën më të mirë nga kompanitë e tyre mëmë, si edhe nga mjedisi favorizues ndaj biznesit në vendin e tyre. Thuajse të gjitha kompanitë janë anëtare të shoqatave të ndryshme të biznesit, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre në vend. Një ndër mangësitë që u vu re ishte fakti se zakonisht kompanitë nuk hartojnë dhe botojnë një raport vjetor që lidhet me veprimtarinë e tyre dhe politikën e CSR-së.

Duke theksuar rëndësinë e zbatimit të CSR-së dhe promovimin e saj nga kompanitë në Shqipëri, vetë industrinë nxjerrëse duhet të vazhdojnë të ndajnë përvojat e tyre dhe të punojnë për vizibilitetin e praktikave të mira, të trashëguara nga kompanitë mëmë përkatëse, drejt një efekti *spill-over* pozitiv në fushat ku ato veprojnë në Shqipëri. Në fund të raportit ofrohen disa rekomandime, të cilat u adresohen bizneseve në industrinë nxjerrëse të synuara, si dhe trajtojnë marrëdhëniet e tyre me aktorët kryesorë të interesuar dhe mjedisin ku ato kryejnë veprimtarinë e tyre.

**TABELA E LËNDËS**

	PARATHËNIE.....	1
	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1.	HYRJE & TERMAT E REFERENCËS.....	7
2.	METODOLOGJIA E PUNËS.....	9
3.	FAKTE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI CSR-në NË SHQIPËRI.....	11
4.	PËRMBLEDHJE E VIZITAVE NË TERREN.....	15
5.	GJETJET DHE PROBLEMATIKA NGA TAKIMET DHE INTERVISTAT.....	17
5.1	Sektorët e biznesit.....	17
5.1.1	Spektori i minierave.....	17
5.1.2	Spektori i naftës dhe gazit.....	20
5.1.3	Spektori i çimentos.....	23
5.1.4	Spektori i hidrocentraleve.....	28
5.2	Aktorët kryesorë.....	32
5.2.1	Qeveria qendrore.....	32
5.2.2	Njësitë e Qeverisjes Lokale.....	39
5.2.3	Organizatrat Joqeveritare.....	41
5.2.4	Projektet e Donatorëve.....	43
6.	PËRFUNDIM.....	45
7.	REKOMANDIME.....	49
8.	SHTOJCA.....	51
8.1	PRAKTIKA MË E MIRË NË SHQIPËRI – RAST STUDIMI.....	51
8.1.1	Titan Group.....	51
8.1.2	Bankers Petroleum.....	52
8.2	Formulari i Pyetësorit për Bizneset.....	54
8.3	Pyetje orientuese për qeverinë qendrore dhe njësitë e qeverisë vendore.....	57
8.4	Foto nga kompanitë e intervistuar.....	58
8.5	Bibliografia.....	60





## 1. HYRJE & TERMAT E REFERENCËS

Në ditët e sotme të gjitha kompanitë ndërkombëtare përpiqen të arrijnë suksesin përmes angazhimit për të vepruar në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme. Menaxhimi i çështjeve që lidhen me shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe komunitetin konsiderohet një pjesë integrale e veprimtarive të biznesit. Të gjitha këto lidhen me të ashtuquajturën Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR), sipas së cilës kompanitë në të gjithë botën krijojnë politika, të cilat përcaktojnë përgjegjësitë, standardet dhe kuadrin për menaxhimin në mënyrë efektive të të gjitha çështjeve që lidhen me to.

Sot, CSR-ja po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në botën e biznesit. Kjo shpjegon faktin se disa përcaktime lidhen me CSR-në, si më poshtë: “Përgjegjësia e sipërmarrjeve për ndikimet e tyre në shoqëri”; “Angazhimi i verifikueshëm i kompanive për të operuar në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, sociale dhe mjedisore, e cila është transparente dhe kërkon gjithnjë e më shumë të kënaqë aktorët e interesuar”; “Mënyra se si kompanitë menaxhojnë proceset e biznesit për të prodhuar një ndikim të përgjithshëm pozitiv tek shoqëria”; “Një proces për të arritur zhvillim të qëndrueshëm në shoqëri”, e kështu me radhë.

CSR-ja në industrinë nxjerrëse është me interes të veçantë në Shqipëri, duke qenë se ka shumë projekte për naftën dhe minierat, shumë prej të cilëve zotërohen dhe drejtohen nga kanadezë – ndoshta 70% e industrisë së naftës. Duke marrë parasysh se kompanitë kanadeze nuk kanë operuar për një kohë të gjatë në Shqipëri, dhe se CSR-ja është një koncept relativisht i ri në vend, kompanitë kanë deklaruar se përballen me sfida të ndryshme në zbatimin e praktikave të mira sociale dhe mjedisore. Identifikimi i këtyre sfidave do të ndihmojë duke nxitur diskutimin drejt projektimit të llojit të ndihmës që i nevojitet sektorit privat për t’i kapërcyer këto sfida dhe për të nxitur më tej zbatimin e CSR-së.

Ambasada kanadeze në Shqipëri prezantoi një iniciativë të re në 7 – 8 mars 2011, mbi CSR-në në Shqipëri. Kjo iniciativë konsistonte në diskutimin në një tryezë të rumbullakët me kompanitë kanadeze, qeverinë dhe institutet tjera ndërkombëtare që lidhen me këtë fushë, gjë që do të pasohet nga një seminar. Përfundimet e seminarit treguan fushat ku nevojitet më shumë ndërhyrje, si për shembull: promovimi i transparencës në aktivitete dhe institucione, duke mundësuar një pjesëmarrje dhe përfshirje më të madhe të komunitetit, duke siguruar mbrojtje të mjedisit, si dhe adresimin e çështjeve ligjore që lidhen me prodhimin e naftës.

Si vazhdim i iniciativave të sipërpërmendura dhe në kuadër të punës së Prezencës së OSBE-së në çështjet e mirëqeverisjes, duke promovuar metodat pjesëmarrëse në mekanizmin planifikues lokal, duke promovuar pjesëmarrjen publike në Konventën Aarhus dhe duke punuar për promovimin e çështjeve që lidhen me transparencën dhe anti-korrupsionin përmes Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), ambasada kanadeze në Shqipëri dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizuan një seminar të përbashkët të nivelit të lartë në 19 shkurt 2013. Ky aktivitet solli përvojën më të mirë kanadeze për zbatimin e praktikave të mira sociale dhe mjedisore, dhe i ofroi qeverisë, OJQ-ve dhe pjesëtarëve të komunitetit mundësinë për të kuptuar më mirë CSR-në përmes përvojës kanadeze, si dhe do t’i lejojë të shohin se cilat programe mund të transferohen në kontekstin shqiptar. Forumi i Aktorëve Shumëpalësh mbi CSR-në do

të ishte një platformë e mirë për t'i ndarë praktikatat më të mira me kompanitë shqiptare edhe gjatë këtij aktiviteti.

Megjithatë që të kemi një këndvështrim të qartë dhe të plotë mbi situatën aktuale të praktikave të CSR-së në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe ambasada kanadeze në Shqipëri e konsideruan mjaft të rëndësishme kryerjen e një studimi në lidhje me praktikatat ekzistuese të CSR-së në industrinë nxjerrëse në Shqipëri. Studimi u bazua në tetë kompanitë kryesore ndërkombëtare dhe vendase që veprojnë në katër sektorët kryesorë nxjerrës: nafta & gazi, minierat, prodhimi i çimentos dhe hidrocentralet. U kontaktuan gjithashtu edhe disa njësi të qeverisjes lokale, ku kompanitë nxjerrëse kryejnë veprimtarinë e tyre, në mënyrë që të merrej parasysh edhe këndvështrimi i tyre.

Për këtë arsye, gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2012, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri kontraktoi dy ekspertë vendas për kryerjen e një studimi paraprak dhe për të ofruar një panoramë të përgjithshme përmes një analize të situatës mbi praktikatat dhe sfidat e CSR-së në sektorët nxjerrës (siç u përmendën më lart) në Shqipëri, me qëllimin për të nxjerrë në pah çështjet dhe zbulimet kryesore, si dhe për të promovuar disa nga praktikatat më të mira. Përfundimet e këtij studimi u prezantuan gjatë seminarit të nivelit të lartë në 19 shkurt 2013.

Detyrat kryesore të konsulentëve përfshinin, por nuk ishin të kufizuara me kaq, si më poshtë:

- Takim në terren me 8 kompanitë kryesore ndërkombëtare dhe të huaja për të kontrolluar praktikatat e tyre ekzistuese për CSR-në dhe për të diskutuar sfidat e tyre për zbatimin e CSR-së në Shqipëri;
- Takim në terren me 3 njësi të qeverisjes lokale (komuna & bashki) për të marrë këndvështrimet e tyre në lidhje me praktikatat e CSR-së në kompanitë që veprojnë në territorin e tyre;
- Takim në terren me 2 organizata të shoqërisë civile dhe pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit në mjediset e industrisë nxjerrëse;
- Takime me 4 përfaqësues (të cilët janë përgjegjës për politikatat e CSR-së) nga qeveria qendrore, përfshi këtu Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia Kombëtare për Burimet Natyrore;
- Takim me përfaqësues të programit të PNUD-it;
- Kontroll i të gjitha politikave të CSR-së dhe i kodeve ekzistuese në fushën e industrive nxjerrëse dhe verifikimi në mënyrë që të shmangim mbivendosje, si për shembull IFC/PNUD;
- Përgatitja e një raporti fillestar dhe një raporti përfundimtar në lidhje me gjendjen dhe sfidat e CSR-së në industrinë nxjerrëse që mbulojnë kompanitë më të mëdha të naftës dhe gazit, kompanitë minerare, hidrocentralet dhe fabrikat e çimentos në Shqipëri.

## 2. METODOLOGJIA E PUNËS

Konsulentët kanë bashkëpunuar ngushtë me kompanitë e përzgjedhura nga industritë nxjerrëse përkatëse, ministritë e linjës, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore, OJQ-të, si dhe nga projektet e donatorëve në vend. Gjatë zhvillimit të studimit, vëmendje kryesore iu dha identifikimit të situatës aktuale të CSR-së dhe zbatimit të saj në industritë nxjerrëse përmes diskutimeve me grupet e përfshira. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe ambasada kanadeze kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke i ofruar konsulentëve mbështetje për të krijuar kontakte dhe marrëdhënie me aktorët e interesuar, si kompanitë e biznesit, agjencitë qeveritare, shoqëria civile. Përfaqësuesit e komunitetit nuk u kontaktuan gjatë kësaj faze, duke qenë se ata mund të jenë objekt i një kërkimi shtesë.

Si pjesë e qëllimit të punës, shumica e takimeve u kryhen në mënyrë të pavarur nga konsulentët; megjithatë, një përfaqësues i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri është bërë pjesë e disa takimeve sipas mundësisë.

Të gjitha të dhënat dhe informacioni i siguruar në këtë raport janë bazuar vetëm tek informacioni që të intervistuarit menduan se duhet të ndahej me konsulentët dhe të bëhej publik për palët e treta.

Konsulentët kanë ndërthurur metodat sasiore dhe cilësore për këtë studim, me qëllimin për të kombinuar të dhënat e disponueshme, statistikën dhe informacionin nga burimet dytësore me intervistat e drejtpërdrejta me grupet e përfshira.

Konsulentët i kanë zbatuar detyrat që u janë caktuar duke ndjekur metodologjinë e punës siç është përshkruar më poshtë:

- Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale në lidhje me praktikën e CSR-së në Shqipëri, veçanërisht në sektorët e përzgjedhur të industrive nxjerrëse;
- Hartimi i modeleve të ndryshme të pyetësorëve për aktorë të ndryshëm të interesuar;
- Përcaktimi i modelit të kompanive, përfaqësuesit e ministrive të linjës, përfaqësuesit e qeverisë lokale, OJQ-të e përfshira në këtë sektor që trajtojnë çështjet mjedisore, të cilat do të intervistohen;
- Organizimi i takimeve dhe intervistave të detajuara individuale me secilin nga aktorët e interesuar që u përmendën më lart;
- Mbledhja e informacionit dhe analizimi i të dhënave;
- Hartimi i raportit bazuar në zbulimet e përgjithshme.



### 3. FAKTE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI CSR-në NË SHQIPËRI

CSR është zhvilluar si koncept në të gjithë botën në të njëjtën kohë me transformimin ekonomik të Shqipërisë<sup>1</sup>. CSR-ja është bërë një fenomen global dhe baza e të dhënave për CSR-në, *Regjistri i Korporatave*, ka regjistruar 5.736 raporte qëndrueshmërie ose CSR-je, të cilat janë botuar në më shumë se 100 vende në vitin 2010<sup>2</sup>.

Gjatë 10-15 viteve të fundit, përvoja në të gjithë botën ka treguar qartë se adoptimi, integrimi dhe zbatimi i parimeve të CSR-së dhe standardeve të performancës në praktikata e rregullta të biznesit krijon përfitime të shumfishta afatgjata, përfshi këtu: 1) funksionimin e liçensës sociale të kompanive, 2) menaxhimin efektiv të rrezikut të korporatave, 3) besim më i madh tek investitori apo aksioneri, 4) përfitimet që lidhen me reputacionin, 5) mbrojtje e mirëqenies dhe promovimi i përfitimeve ndaj njerëzve dhe mjedisit, të cilët preken nga aktivitetet e korporatës.

Gjatë dy dekadave të fundit, ndërkohë që si globalizimi ashtu edhe integrimi evropian janë zhvilluar me ritme të shpejta, Shqipëria, njësoj si shumë vende të tjera në rajon, ka filluar një rrugëtim ambicioz duke ndërthurur pluralizmin politik, tregjet e hapura dhe konkurrese dhe një shoqëri civile mjaft aktive. Kjo ka tërhequr më shumë vëmendje tek CSR-ja, përmes të cilës bizneset kërkojnë t'i përshtatin veprimet e tyre me ndikimin e tyre social dhe mjedisor.

Për më tepër, zbatimi i standardeve të CSR-së shërben si një mjet për të krijuar përparësi konkurruese për bizneset shqiptare si në rajon ashtu edhe në tregun e gjërë evropian.

Qeveria shqiptare dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), si ministria kryesore, janë të angazhuara të promovojnë CSR-në si një element kyç i konkurrencës së qëndrueshme për kompanitë në Shqipëri dhe për ekonominë shqiptare në përgjithësi. Ndërkohë që Shqipëria vazhdon rrugën e saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), integrimi i çështjeve ekonomike, mjedisore dhe sociale është një detyrë mjaft e rëndësishme për të gjitha pjesët e shoqërisë, përfshi këtu komunitetin e biznesit. Për këtë arsye, është e nevojshme të krijohet një kod i qartë sjelljesh dhe standardesh etike, si edhe treguesish të qartë për CSR-në në Shqipëri.

Një studim për CSR-në, i kryer në kontekstin e Ballkanit Perëndimor<sup>3</sup>, zbuloi se CSR-ja ishte një koncept relativisht i ri në rajon, i cili promovohet kryesisht nga korporatat shumëkombëshe dhe agjencitë për zhvillimin ndërkombëtar. Niveli i të të kuptuarit tek aktorët e interesuar dhe angazhimi i kompanive ishin në një fazë fillestare, duke u përqendruar te filantropia dhe çështjet e mjedisit. Shumë kompani ndërkombëtare kanë integruar standarde në aktivitetet e tyre në fushat e energjisë, ndërtimit, telekomunikacionit dhe në sektorin bankar.

Megjithatë, është e qartë se Shqipëria ka bërë hapat e parë drejt praktikave fillestare të CSR-së. Arritjet më të mëdha deri tani janë përmbledhur shkurt më poshtë: Shqipëria ka krijuar një rrjet lokal të Rrjetit të Kombeve të Bashkuara për Kompaktin Global

1 CSR-ja në Shqipëri, një dokument politikash për Qeverinë e Shqipërisë/METE nga Dr. Paul Stubbs, Instituti i Ekonomisë, Zagreb, Kroaci, maj 2011

2 Bazë të dhënash nga <http://www.corporateregister.com.stats>

3 Koncepti i Studimi Bazë për Praktikata e CSR-së në Ballkanin Perëndimor, UNDP 2008

(UNGCN) në vitin 2005, për të cilin Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) luan rolin e Sekretariatit dhe punon ngushtë me METE-n për të lehtësuar punën e rrjetit. Në fillim, pjesëmarrja e kompanive ishte relativisht e lartë – në vitin 2008, 36 organizata kishin shprehur angazhimin e tyre ndaj parimeve të Rrjetit të Kombeve të Bashkuara për Kompaktin Global (UNGC). Që nga ajo kohë, rrjeti lokal autorizoi krijimin e një dokumenti politikash dhe filloi të zhvillonte plane strategjike. UNGC-ja ka kontribuar për zbatimin e praktikave të CSR-së duke e zhvilluar më tej këtë koncept dhe duke organizuar shumë aktivitete dhe forume që lidhen me të në bashkëpunim të ngushtë me METE-n.

Raporti Global për Përgjegjshmërinë/Indeksi i Konkurrueshmërisë së Përgjegjshme (përfshin 21 tregues për të ofruar një panoramë të mundësive të një vendi për të krijuar kompani të përgjegjshme) i botuar në vitin 2007, mori në analizë 108 vende, nga të cilat Shqipëria u rendit në vendin e 74-t, duke u renditur pak më sipër se vlerësimi mesatar, (krahasuar me Kroacinë, e cila u rendit në vendin e 53-të dhe Maqedoninë në vendin e 65-të).

Gjatë viteve 2007-2008, u zbatua një projekt rajonal i *InWentGmbH Germany* mbi CSR-në në Shqipëri. Ky projekt iu prezantua 250 kompanive në Shqipëri. Kjo ishte hera e parë në Shqipëri që ndaheshin çmime CSR-je për sipërmarrjet e mëdha dhe sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.<sup>4</sup> Kompanitë kishin mundësinë të familjarizoheshin me metodën e CSR-së dhe me fushat kryesore ku CSR-ja mund të zbatohet. Për më tepër, bizneset, aktorët e interesuar dhe përfitues të tjerë kishin mundësinë të mësonin më shumë mbi mënyrat se si mund të kontribuojë CSR-ja për të rritur performancën e biznesit të kompanive dhe për të krijuar një ndikim pozitiv për aktorët e interesuar (personeli, shoqëria, mjedisi, etj.).

Në Indeksin e Konkurrueshmërisë Globale për vitet 2010-2011<sup>5</sup>, Shqipëria u ngjiti në renditje nga vendi i 96-të në vendin e 88-të, nga 139 kompani të përfshira në studim, ndërkohë që në raportin mbi Indeksin e Performancës Mjedisore<sup>6</sup> Shqipëria u rendit në vendin e 23-të nga 163 vende, dhe në vitin 2012 u rendit në vendin e 15-të me 65,85 pikë, duke u konsideruar kështu një ndër vendet me performancë më të mirë.<sup>7</sup>

Sipas strategjisë së rinovuar të Komisionit Evropian për CSR-në, e cila u botua në tetor të vitit 2011, një rëndësi e madhe i është dhënë zhvillimit të strategjive kombëtare për CSR-në dhe metodave shumëpalëshe. Pritet që të gjithë shtetet anëtare të kenë një CSR kombëtare brenda vitit 2014<sup>8</sup>. Për këtë arsye, kjo është mjaft e përshtatshme për Shqipërinë, e cila aspiron të bëhet pjesë e BE-së.

Në kuadër të UNGC-së, në maj të vitit 2011 u hartua një dokument politikash mbi CSR-në. Ky dokument e përshkruan perceptimin dhe adoptimin e CSR-së si relativisht të ndërlikuar.<sup>9</sup> Nga ana tjetër, shumë kompani janë angazhuar në lidhje me CSR-në dhe ka një ngritje të standardeve, si për shembull seria ISO 9000. Nga ana tjetër, interesi dhe përditësimi nga sektori privat mbetet i vogël, dhe përfaqësimi i kompanive bëhet

4 Ceremonia për ndarjen e çmimeve të CSR-së e organizuar nga Tirana RDA, Tiranë, mars 2008

5 Forumi Botëror i Ekonomisë, 2010

6 Indeksi i Performancës Mjedisore, Raporti I, 2010

7 <http://epi.yale.edu/epi2012/rankings>

8 Një strategji e re e BE-së për CSR-në 2011-2014, Bruksel, 25.11.2011

9 Dr. Paul Stubbs (maj 2011) CSR-ja në Shqipëri: Një dokument politikash për METE-n, Universiteti i Zagrebit, Kroaci

kryesisht nga kompanitë e mëdha dhe ato shumëkombëshe. Mesa duket, ushtrohet pak presion nga konsumatorët, qeveria apo vetë bizneset për të nxitur ndryshim. Si i tillë, nocioni i CSR-së në Shqipëri është kryesisht filantropik, ndryshe nga disa vende të tjera, ku CSR-ja lidhet ngushtë me funksionimin bazë të biznesit.

Pavarësisht nga sfidat e tanishme për zbatimin e legjislacionit për CSR-në, METE është angazhuar për promovimin e standardeve sociale dhe mjedisore, si një burim shtesë i konkurrueshmërisë dhe rritjes së qëndrueshme për kompanitë shqiptare në tregun lokal dhe atë global. PNUD-i po kontribuon për promovimin e axhendës së CSR-së mes aktorëve lokalë në Shqipëri.

Në këtë kuadër, PNUD-i dhe METE menduan se ky rrjet do të përfitonte duke e zgjeruar pjesëmarrjen me grupe të tjera të aktorëve të interesuar, veçanërisht në kontekstin e përparësisë së dhënë nga BE-ja ndaj metodave shumëpalëshe. Për pasojë, PNUD-i dhe METE së bashku lehtësuan krijimin e Forumit të Aktorëve Shumëpalësh (*Multi-stakeholders Forum - MSF*) për CSR-në në dhjetor të vitit 2011 në Tiranë. Ky forum është aktiv dhe ka organizuar disa takime mbi tema të ndryshme: a) matja e performancës së CSR-së në nivelin kombëtar në Shqipëri në prill të vitit 2012 dhe b) CSR-ja në Shqipëri në dhjetor të vitit 2012. Takimi i fundit pasoi rekomandimet e takimit të mëparshëm të Forumit, i cili u mbajt në muajin prill. Atje u prezantuan konceptet bazë të ISO 26000 dhe standarde të tjera ndërkombëtare (si për shembull ISO 14001, OHSAS 18001 dhe SA 8000). Forumi sqaroi konceptet e përgjegjësisë sociale (PS) dhe përgjegjësisë sociale të korporatave (CSR) si nga ana teorike ashtu edhe përmes përvojave të kompanive të sektorit privat. Qëllimi i tij kryesor ishte të ndihmonte sektorin privat, si dhe aktorë të tjerë të interesuar, t'i përkthenin këto parime në veprime efektive.

Si rezultat i bashkëpunimit mes METE-s dhe PNUD-it, u hartua një Plan Kombëtar Veprimi (PKV) për CSR-në, i cili do të zbatohet në Shqipëri. Ky PKV shërben si një hartë që udhëheq përpjekjet e aktorëve të interesuar në këtë fushë dhe thekson rëndësinë e matjes së performancës dhe progresit të CSR-së. U identifikua një grup prej 22 treguesish kombëtarë në fusha të ndryshme. Këta tregues do të shërbejnë si elementët bazë për matjen e performancës pasi të jenë përcaktuar standardet. Forumi ka filluar të planifikojë matjen e performancës së CSR-së në sektorët kyç të ekonomisë. Çështjet kryesore të CSR-së që mbulohen nga Plani Kombëtar i Veprimit përfshijnë: puna, mjedisi, komuniteti dhe rrjeti i dyqaneve, korrupsioni dhe transparenca, qeverisja e korporatave, konsumatorët/produktet.

Në dhjetor të vitit 2011, METE, e mbështetur nga Shërbimet Këshilluese të IFC-së, miratoi Kodin e Qeverisjes së Korporatave për kompanitë e palistuar<sup>10</sup> në Shqipëri. Ky kod thekson parimet kryesore që drejtojnë një biznes; është mjaft e dobishme për kompanitë që ta përfshijnë atë në praktikën e tyre pavarësisht faktit që kjo nuk është e detyrueshme.

Për më tepër, PNUD-i në bashkëpunim me Drejtorinë e Standardizimit kanë punuar për përshtatjen e ISO 26000. Ky standard do të shërbejë si një bazë për zhvillimin e produkteve, shtimin e ndërgjegjësimit dhe trajnimeve pasuese mbi CSR-në.

Në datën 12 qershor, një trajnim një-ditor mbi median iu ofrua 14 gazetarëve nga media

<sup>10</sup> Kodi për Qeverisjen e Korporatave u miratua për kompanitë e palistuar duke qenë se Bursa e Tiranës nuk është funksionale, e për pasojë nuk ka kompani të listuara.

lokale, duke u dhënë kështu më shumë njohuri për raportimin e saktë të CSR-së. Trajnimi u zhvillua në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të PNUD-it në Bratislavë për Evropën dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura (Commonwealth of Independent States – CIS).

Ndërkohë që kompanitë shqiptare dhe kompanitë shumëkombëshe që veprojnë në Shqipëri konkurrojnë në tregjet e globalizuara, niveli i angazhimit për të integruar CSR-në në të gjitha aspektet e vizionit strategjik dhe praktikave të kompanisë do të jetë një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm për të krijuar përparësi konkurruese, një vend më të madh në treg dhe në fund, shtimin e përfitimit. Ekziston një shtim i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e angazhimit të CSR-së në lidhje me menaxhimin e risqeve, krijimin dhe mbrojtjen e reputacionit, shtimin e transparencës, dhe përmirësimin e Qeverisjes së Korporatave. Kompanitë që investojnë në mbrojtjen e mjedisit, në rekrutim, trajnime dhe në ruajtjen e një force pune të aftë, si dhe në ndërtimin e partneriteteve domethënëse në komunitet kanë më shumë mundësi të mbijetojnë dhe të zhvillohen në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.



#### 4. PËRMBLEDHJE E VIZITAVE NË TERREN

Konsulentët kryen një sërë vizitash në terren dhe organizuan takime me përfaqësues të biznesit nga sektoret e synuar të industrive nxjerrëse, si dhe me aktorët e interesuar dhe OJQ-të. Një listë e detajuar e takimeve të organizuara dhe detajet e kontakteve janë vendosur në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Kompania/ Institucioni	Përfaqësuesi	Pozicioni	Telefon	E-mail
1	TIREX Explorations Ltd	Prof. Perparim Alikaj	Koordinator	068 2020101	<a href="mailto:alikalj@albmail.com">alikalj@albmail.com</a>
2	Albanian Chrome - ACR	Znj. Laura Xhaxho	Menaxhere Zyre	04 2242938	<a href="mailto:laura.xhaxho@albanianchrome.com">laura.xhaxho@albanianchrome.com</a>
3	Stream Oil & Gas Ltd	Z. Fatbardh Ademi	Zv. Menaxher i Përgjithshëm	069 6046433	<a href="mailto:fademi@streamoilandgas.com">fademi@streamoilandgas.com</a>
4	Bankers Petroleum Albania Ltd	Znj. Barbara Lamb	Menaxhere e Marrëdhënieve të Komunikimit	034 22 08 45/6/7	<a href="mailto:blamb@bankerspetroleum.com">blamb@bankerspetroleum.com</a>
5	Titan Group - Antea Cementsh.a.	Z. Dritan Nako Znj. Edlira Nasi	Menaxher i Komunikimit Menaxher për Administrimin dhe Marrëdhëniet me Jashtë Menaxhere e CRS-së	069 4075019	<a href="mailto:dnako@anteacement.al">dnako@anteacement.al</a> <a href="mailto:enasi@anteacement.al">enasi@anteacement.al</a>
6	FusheKruja Cement	Z. Alexander Bouri	Administrator	069 40 08 866	<a href="mailto:Charles.bouri@fkcementfactory.com">Charles.bouri@fkcementfactory.com</a>
7	Energy Ashtashpk	Z. Dietmar Reiner Znj. Peter Stelzer	Drejtor Menaxhimi Drejtor Menaxhimi	044 50 42 37	<a href="mailto:Dietmar.reiner@energji-ashta.al">Dietmar.reiner@energji-ashta.al</a>
8	Devolli Hydropower	Znj. Viola Puci	Menaxhere e Marrëdhënieve me Publikum/Komunikimit	069 4082705	<a href="mailto:viola.puci@devollhydropower.al">viola.puci@devollhydropower.al</a>
9	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Z. Vasil Dodi	Drejtor i Politikës për Marrëdhëniet në Punë	044 504 950	<a href="mailto:Vasil.dodi@mpcs.gov.al">Vasil.dodi@mpcs.gov.al</a>
10	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit	Z. Alfred Deshati	Drejtor i Kontrollit të Mjedisit	067 20 21 000	<a href="mailto:alfred.deshati@moe.gov.al">alfred.deshati@moe.gov.al</a>
11	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë	Z. Bashkim Sykja	Drejtor për Konkurrencën dhe Mbeshtetjen në Biznes	067 20 80 026	<a href="mailto:Bashkim.sykja@mete.gov.al">Bashkim.sykja@mete.gov.al</a>

12	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Z. Muhamet Curri Z. Edmond Goskollli Z. Kleves Janku Z. Artan Leskoviku Znj. Blerina Kazafëri	Drejtor i Mimirave Konsulent Teknik Drejtor i Sektorit të Ligjit Drejtori i Sektorit të Energjisë Drejtoreshë e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashitë	04 22 46 195	m.curri@akbn.gov.al e.goskollli@akbn.gov.al k.janku@akbn.gov.al a.leskoviku@akbn.gov.al b.kazafëri@akbn.gov.al
13	Bashkia e Patosit	Znj. Rajmonda Ballilaj	Kryetare Bashkie	069 54 51 562	r.ballilaj@bashkiapatosit.gov.al
14	Bashkia e Fushë-Krujës	Z. Gjon Bardhi	Kryetar Bashkie	068 20 82 888	gjonbardhi@live.com
15	Bashkia e Bulqizës	Z. Roland Keta	Kryetar Bashkie	068 2334952	n/a
16	Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve	Z. Ilir Aliaj	Drejtor Ekzekutiv	069 2095284	ilir.aliaj@gzhdh-al.org
17	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse	Z. Shkelqim Hysaj	Drejtor	069 2066775	hysaj_sh@yahoo.com
18	Projekt i PNUD-it	Znj. Jorina Kadare	Oficere Projekti	069 40 94 678	Jorina.kadare@undp.org

## 5. GJETJET DHE PROBLEMATIKA NGA TAKIMET DHE INTERVISTAT

### 5.1 SEKTORËT E BIZNESIT

Në mënyrë që të kemi një panoramë më të qartë të gjendjes së Përgjegjesisë Sociale të Korporatave në Shqipëri në lidhje me industrinë nxjerrëse, u morën në shqyrtim katër sektorët përkatës të biznesit. Këta sektorë përfshijnë: minierat, naftën dhe gazin, çimenton dhe hidrocentralet. U vizituan tetë kompani, dhe në bazë të intervistave dhe diskutimeve me përfaqësuesit e tyre u identifikuan disa çështje dhe u analizuan për qëllim të këtij studimi. Më poshtë janë sjellë zbulimet dhe çështjet kryesore, të cilat janë marrë nga bisedat e drejtpërdrejta me përfaqësuesit e kompanive.

#### 5.1.1 Sektori i minierave

##### **TIREX Explorations Ltd.**

###### *1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti*

*Tirex Explorations Ltd.* e ka filluar aktivitetin për Kërkim dhe Zhvillim në Shqipëri në vitin 2006. Puna kërkimore është kryer kryesisht për burimet minerare në zonat e Qafës së Malit në Pukë dhe Perlatit në Rrëshen, në një gjatësi prej 44 km dhe gjerësi prej 5-6 km. Një fotografi ajrore është bërë për të verifikuar se po gërmohet deri në 200 metra thellësi në zonën e pasur me minerale.

Kompania aplikoi dhe mori lejen për kërkim dhe zhvillim në vitin 2007, kur ajo filloi edhe shpim-kërkimet. Liçensa e eksplorimit nuk është dhënë ende. Zonat në të cilat është përqendruar kompania nuk konsiderohen nga më të pasurat në bakër, zink, argjend dhe ar.

###### *2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së*

Zhvillimi i praktikave më të mira në lidhje me stafin dhe punonjësit e kompanisë, mjedisin dhe shoqërinë, për sa i takon CSR-së, është pjesë e strategjisë së kompanisë. *Tirex Explorations Ltd.* e ka përfshirë CSR-në në strategjinë e saj si një nga shtyllat kryesore, pavarësisht faktit se ky nuk është një kusht i domosdoshëm apo i detyrueshëm në Shqipëri.

###### a. Stafi/Punonjësit

*Tirex Explorations Ltd.* ka punësuar rreth 40 punonjës dhe teknikë, si dhe 6 roje të nënkontraktuar. Shpesh kompania u jep udhëzime punonjësve të saj në terren dhe menaxherëve përkatës në bashki për situatën e pyjeve, dhe kujdeset që të mos dëmtojë pemët. Gjatë viteve të veprimtarisë së saj, kompania ka krijuar vende pune dhe ka firmosur me punonjësit e saj në terren kontrata individuale.

###### b. Komuniteti

*Tirex Explorations Ltd.* është shumë e përgjegjshme ndaj komunitetit dhe shpesh ofron mbështetje në mënyra të ndryshme. Kompania ka rikonstruktuar rrugët lokale në Munella me një gjatësi prej 20 km. Shumë shpesh, kompania ndihmon fermerët gjatë periudhave kur vendi mbulohet nga dëbora, duke u ofruar autoriteteve lokale buldozerë për të pastruar rrugën nga dëbora në Gjegjan. Aktualisht, kompania po punon për të hapur rrugën që lidh bashkinë e Gjegjanit me atë të Qafë Malit.

Gjatë periudhës 2009 – 2012, kompania ka siguruar një autobus për të shoqëruar fëmijët në shkollë në fshatin Repts. Për më tepër, kompania ka dhënë bursa studimi për tre studentë të shkëlqyer, vlera e të cilave arrin në 4.500 Euro.

### c. Mjedisi

Kompania ka kontraktuar një agjenci lokale për mjedisin për të kryer një studim në zonë në mënyrë që të identifikojë nivelin e ndotjes dhe të zhvillojë planin përkatës të ndërhyrjes. Për shkak të shfrytëzimit të tepërt të zonës, aty ka grumbuj të mëdhenj mbeturinash prej bakri, etj. Në këtë aspekt, kompania ka zhvilluar një program ndërhyrjeje për pastrimin e tokës dhe ujit nga ndotja kimike, duke krijuar kështu një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv te komuniteti lokal.

### 3. *Bashkëpunimi me Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV-të), qeverinë qendrore dhe organizatat joqeveritare (OJQ-të).*

Zëvendës drejtori i kompanisë, z. Perparim Aliko, është anëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, e cila është një forum i madh ndërkombëtar, ku qeveria shqiptare aderon të bëjë pjesë. Z. Aliko është ftuar si përfaqësues i *Tirex Explorations Ltd.* si një nga ekspertët që do të ndërtojnë një dialog më të ngushtë me qeverinë.

### 4. *Problemet me të cilan përballen*

N/A

### 5. *Planet për të ardhmen*

Një aspekt i drejtpërdrejtë ku ndërthuren elementët e CSR-së është marrja në punë e stafit lokal. Në këtë drejtim, kompania po planifikon të rekrutojë më shumë se 200 punonjës lokalë me fillimin e veprimtarisë dhe eksplorimit të zonës minerare. Për informacion më të detajuar shkoni në [www.tirexresources.com](http://www.tirexresources.com)

## **Albanian Chrome - ACR**

### 1. *Histori e shkurtër dhe aktiviteti*

*Albanian Chrome* ka kryer aktivitetin e saj në sektorin e minierave në Shqipëri që nga viti 2000. Kompania e saj mëmë është vendosur në Austri. Kompania ka firmosur një marrëveshje koncesionare 35-vjeçare me qeverinë e Shqipërisë. Përveç minierës së Bulqizës, kompania po kryen veprimtarinë e saj edhe në Uzinën e Ferrokromit në Elbasan. *Albanian Chrome - ACR* merret me nxjerrjen e mineralit, përpunimin dhe eksplorimin e produkteve të tij.

### 2. *Ndikimi dhe arritjet e CSR-së*

Koncepti i CSR-së duket diçka e re për menaxherin e zyrës.

#### a. Stafi/Punonjësit

Kompania ka firmosur me punonjësit e saj në terren kontrata sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës së Shqipërisë. Punonjësit në zyrat qendrore kanë firmosur kontrata të hapura. Për më tepër, janë firmosur kontrata kolektive në minierën e kromit në Bulqizë, në uzinën e ferrokromit në Elbasan dhe në uzinën e ferrokromit në Burrel. Kjo e fundit nuk ka funksionuar që nga viti 2008; megjithatë, aktualisht 92 punonjës përfitojnë ende duke u paguar me 50% të pagës.

Nuk janë planifikuar trajnime për zhvillim në karrierë, përveç rasteve specifike. Zakonisht

ofrohen vetëm trajnime fillestare për stafin e ri. Kompania jep paga më të mira për punonjësit e saj në krahasim me pagat që japin institucionet shtetërore për personat që kanë diplomë universitare. Punonjësit motivohen me marrjen e rrogës së 13-të në fund të vitit.

Kompania gjithashtu ofron kushte shumë të mira pune për stafin e saj, si për shembull garderobë, dushe, dieta (me para në dorë ose sigurohet qumështi për minatorët).

### b. Komuniteti

*Albanian Chrome* ka bërë disa sponsorizime në zonën ku ajo kryen veprimtarinë e saj. Vlen të përmendet rikonstrukcioni i spitalit të Bulqizës, organizimi i festës së Vitit të Ri për fëmijët e minatorëve të Bulqizës, si dhe ofron deri në 3 rroga parapagesë në rast emergjencash dhe nevojë (këto para paguhen me këste të vogla çdo muaj nga punonjësi) dhe 1 rrogë shtesë në rastin e një fatkeqësie familjare.

Për më tepër, është bërë tashmë një traditë që në fund të vitit, aksioneri i kompanisë ofron veshje (marka Benetton) për familjet e minatorëve të Bulqizës. Kjo praktikë është zbatuar gjatë dy viteve të fundit.

### c. Mjedisi

Transporti i produkteve kryhet përmes një pale të tretë, e cila është përgjegjëse për standardet e kërkuara dhe ndikimin në mjedis. Kompania nuk ka aplikuar asnjë nga standardet ISO dhe nuk është certifikuar. Aktualisht, ajo ka ri-aplikuar për leje mjedisore në Ministrinë e Mjedisit, por leja nuk është lëshuar ende për shkak të procedurave burokratike. Ministria e Mjedisit kryen monitorimin e situatës dhe të veprimtarisë së biznesit, dhe kompania raporton për të dhënat e kërkuara.

### 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të

*Albanian Chrome* është anëtare e Shoqatës së Investitorëve të Huaj të Shqipërisë, Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Austri dhe Dhomës së Tregtisë. Kompania ka marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta së bashku me biznese të tjerë të ngjashëm për të diskutuar çështje, plane të ndryshme, etj. *Albanian Chrome* nuk përgatit apo boton një raport vjetor, por është mjaft e gatshme të ofrojë informacionin e nevojshëm për aktorët e interesuar në rast se i kërkohet ta bëjë këtë. Kohët e fundit, kompania ka filluar të botojë një buletin mujor. *Albanian Chrome* po konsideron hapjen e një pusi të ri në Bulqizë, gjë që nënkupton vende të reja pune për komunitetin. Gjithashtu, uzina e Klosit do të bëhet funksionale. Këto projekte do të diskutohen në këshillin bashkiak të Klosit, si dhe me komunitetin, i cili deri tani ka dhënë mbështetjen e tij.

### 4. Problemet me të cilat përballen

*Albanian Chrome* është përballur me shumë probleme, si protesta, greva, aksidente (përfshi vdekjen e minatorëve), të cilat janë bërë publike përmes medias<sup>11</sup>. Arsyeet kryesore pse minatorët dalin në grevë janë kërkesat e tyre për rroga më të larta dhe kushte më të mira pune. Megjithatë, duhet përmendur fakti se (ky fakt u theksua si nga përfaqësuesi i kompanisë edhe nga përfaqësuesi i AKBN-së) ndonjëherë kërkesat e

<sup>11</sup> Sipas burimeve të medias, punonjësit e *Albanian Chrome* organizuan një protestë gjatë ditëve të fundit të dhjetorit për shkak të faktit se kompania nuk u dha pagën e 13-të. Pas protestës, 700 minatorë deklaruan se nuk kanë marrë pagën e 13-të siç është përcaktuar në kontratën që ata firmosën vetëm pak ditë më parë me përfaqësuesit e kompanisë. Një përfaqësues i minatorëve tha se në ditët në vijim ata do të bllokoni pusin e kompanisë dhe nuk do të lejonin nxjerrjen e kromit.

minatorëve janë mjaft të larta dhe thuajse jorealiste.

## 5. Planet për të ardhmen

N/A

### 5.1.2 Sektori i naftës dhe gazit

#### **Stream Oil&Gas Ltd**

##### *1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti*

*Stream Oil&Gas Ltd.* është një kompani me bazë në Kanada, e cila merret me prodhimin, zhvillimin dhe eksplorimin e naftës & gazit, dhe që kryen aktivitetin e saj në Shqipëri që nga viti 2007. *Stream Oil&Gas Ltd.* e cila drejtohet nga një ekip menaxhimi me përvojë teknike, po zbaton një teknikë moderne dhe të përparuar rigjenerimi për rezervuarët e karbonit. Aktualisht, *Stream*-i është përqendruar në ri-aktivizimin dhe ri-zhvillimin e projekteve aktuale të prodhimit në Shqipëri: tre fusha naftë të rëndë tokësore, Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Gorisht-Kocul dhe një fushë tokësore për prodhimin e gazit, dhe njëkohësisht Delvina është një zonë ku po zhvillohen kërkime. Bazuar në marrëveshjen e naftës me Albpetrol sh.a, me kompaninë e shtetit shqiptar për eksplorim dhe prodhim, dhe në marrëveshjen për lejen 25-vjeçare me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), *Stream Oil&Gas Ltd.* ka të drejtën të shfrytëzojë të gjithë pusët në të katër fushat e naftës, si dhe të përfitojë një pjesë të prodhimit bazë aktual dhe 100% të prodhimit të shtuar.

##### *2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së*

*Stream*-i është një kompani ndërkombëtare, e cila e kryen aktivitetin e saj ekonomik në bazë të standardeve kanadeze, përveç standardeve që kërkohen në Shqipëri, ku ajo vepron. Kompania zbaton të njëjtat standarde për mjedisin, punën dhe parimet etike si në Kanada duke qenë se ajo renditet në tregun e bursës.

##### a. Stafi/Punonjësit

Kompania i ka sponsorizuar punonjësit për çdo problem shëndetësor apo aktivitete të tjera në këtë zonë. Në fakt, ajo aplikon kontrata individuale me personelin e saj. Për më tepër, kompania bashkëpunon ngushtë me sindikatën e punëtorëve, duke u bazuar në vullnetin e mirë dhe duke kuptuar rolin e saj.

##### b. Komuniteti

Marrëdhënia e kompanisë me komunitetin konsiderohet si mjaft e rëndësishme. Sipas ligjit, një kompani shfrytëzimi nuk është përgjegjëse për ndotjen apo dëmin që është shkaktuar në të shkuarën nga kompanitë e mëparshme të shfrytëzimit. Megjithatë, në mënyrë që të jetë miqësore ndaj komunitetit dhe mjedisit, *Stream Oil&Gas Ltd.* ka kontribuar në mënyra të ndryshme duke ndërhyrë për të riparuar dëme të ndryshme në infrastrukturë, tubacione, e kështu me radhë.

Kompania ka krijuar strategjinë e saj të komunikimit, përmes së cilës informohet i gjithë komuniteti dhe aktorët e tjerë që kanë lidhje me të mbi çdo investim, veprim apo plan, i cili në fund duhet të sjellë përfitime për të gjithë zonën, si për shembull përgjegjësia e kompanisë për ri-strukturimin e rrugëve të reja, mbjelljen e pemëve, kontrollin e zjarreve, etj.

### c. Mjedisi

Çështjet mjedisore mbeten mjaft delikate si për kompaninë ashtu edhe për komunitetin. Kompania ka implemetuar të ashtuquajturat sisteme të mbyllura të gazit. Gazi që shfrytëzohet në këto burime është helmues, e për pasojë rrjedhja e tij në atmosferë mund ta ndotë ajrin. Kompania ka rinovuar lidhjet mes gazsjellësve në mënyrë që të kontrollojë dhe sigurojë rrjedhjen e gazit dhe të minimizojë në maksimum rrjedhjen në atmosferë. Kompanisë i është dhënë leja mjedisore përkatëse, e cila duhet të rinovohet çdo vit. Ajo është monitoruar nga autoritetet përkatëse në çdo aspekt, dhe fakti që leja mjedisore është rilëshuar tregon se të gjitha kushtet paraprake janë plotësuar, e për pasojë deri tani nuk ka asnjë pengesë. Kompania ka kontraktuar një agjenci lokale për mjedisin, e cila monitoron aktivitetin e saj në lidhje me plotësimin e standardeve mjedisore. Kjo agjenci raporton në mënyrë periodike si tek lidhshipi i kompanisë ashtu edhe tek autoritetet e jashtme, dhe ka detyrimin të vërtetojë që standardet e sipërpërmendura janë plotësuar.

#### 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të

Kompania është mjaft e kujdesshme për ndërtimin e një dialogu të vazhdueshëm, i cili ka për qëllim arrijten e një bashkëpunimi më të mirë me njësitë e qeverisjes vendore. Kompanisë iu kërkua të përcaktonte ndarjet administrative të burimeve që do të shfrytëzohen në zonat që mbulohen prej saj, dhe ajo e ka bërë këtë në mënyrë neutrale. Qëllimi ishte përcaktimi i saktë i rentës minerare që i përket secilës komune apo bashkie. Në këtë rast, *Stream Oil&Gas Ltd.* ka siguruar qeverinë, Ministrinë e Financave, dhe ka konfirmuar ndarjet e duhura mes Njësive të Qeverisjes Vendore për sa i përket rentës minerare për çdo NjQV. Në fakt, renta minerare ndahet me ligj nga qeveria për njësitë administrative.

#### 4. Problemet me të cilat përballen

Më përpara kompania shfrytëzonte burimet ekzistuese të naftës, të cilat kishin qenë funksionale për një kohë të gjatë (rreth 30/40 vjet) në Shqipëri. Kur kompanisë iu dha koncesioni për këto burime, infrastruktura e tyre e përgjithshme ishte shumë e dobët dhe e dëmtuar. Për më tepër, duke qenë se ishin shfrytëzuar për një kohë të gjatë nga sipërmarrjet shtetërore, aspektet mjedisore të këtyre burimeve ishin neglizhuar plotësisht. Për pasojë, ishte e pamundur për kompaninë që ajo të zëvendësonte infrastrukturën e dëmtuar me infrastrukturë të re brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Përveç kësaj, kompania ka probleme me grumbulluesit e skrapit, të cilët shpesh e shkatërrojnë gazsjellësin në mënyrë që të vjedhin metal për skrap nga strukturat në fushën e naftës.

#### 5. Planet për të ardhmen

Qëllimi i parë i kompanisë është që *Stream Oil&Gas Ltd.* të mos shkaktojë ndotje në zonë, siç ka ndodhur në rastet e mëparshme. Në këtë aspekt, kompania po merr masa në mënyrë që tubat e naftës të mos lëshojnë naftë në tokë, apo po heq tubat që lëshojnë gaz në atmosferë, duke shmangur kështu ndotjen.

Kompania ka projektuar një plan për një investim afatgjatë, i cili do të implemetohet në disa faza.

### **Bankers Petroleum Albania Ltd**

#### 1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti

*Bankers Petroleum Albania Ltd.* është një kompani me bazë në Kanada e përqendruar në shfrytëzimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës & gazit, e cila ka për qëllim të maksimizojë vlerën e aseteve të naftës së rëndë në Shqipëri. Kompania ka si synim shtimin e prodhimit dhe rezervave përmes aplikimit të teknologjive të reja dhe të provuara, me ndihmën e një grupi ekspertësh teknikë me përvojë. *Bankers Petroleum Albania Ltd.* vepron dhe ka të drejta të plota të shfrytëzojë fushat e naftës së rëndë në Patos-Marinzë dhe Kuçovë në bazë të një marrëveshjeje 25-vjeçare me Agjencinë Kombëtare të Buri-meve Natyrore dhe një Marrëveshje Naftë me Albpetrol sh.a.

Fusha e naftës Patos-Marinzë është fusha më e madhe e tillë bregdetare në Evropën kontinentale, dhe ka afërsisht 7.7 miliardë fuçi naftë bruto. Fusha e naftës në Kuçovë ka 297 milionë fuçi naftë bruto.

Për më tepër, *Bankers Petroleum Albania Ltd.* ka një licensë shfrytëzimi 7-vjeçare në një bllok prej 185.000 akrash, të quajtur «Blok F», i cili është vazhdimësi e fushës së naftës Patos – Marinzë dhe gjithashtu ka perspektivë për gaz natyror.

## 2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së

Përmes konceptit të CSR-së, *Bankers Petroleum Albania Ltd.* integron çështjet sociale dhe mjedisore në veprimtaritë e biznesit të saj. Në lidhje me CSR-në, kompania ka kontaktuar me një sërë ekspertësh që kanë lidhje me komunitetin. Kompania është e përgjegjshme ndaj komunitetit dhe ka për qëllim të stimulojë ekonominë lokale në zonë, të marrë masa për krijimin e vendeve të punës dhe të përmirësojë cilësinë e jetës. Përmes mekanizmit të saj të brendshëm dhe të jashtëm, kompania mundohet të shtojë ndërgjegjësimin në lidhje me CSR-në.

### a. Stafi/Punonjësit

Kompania kujdeset për punonjësit e saj në lidhje me çështjet shëndetësore, trajnimet dhe kualifikimet e mëtejshme përmes seminarëve të ndryshëm.

### b. Komuniteti

Kompania aspiron të bashkëpunojë ngushtë me anëtarët dhe punonjësit e komunitetit, duke ofruar këshilla, njohuri, dhe aty ku është e përshtatshme, fonde për mirëqenien e komunitetit, për projekte kulturore, arsimore dhe për infrastrukturën. Kompania po zbaton një program investimi për një zhvillim të vazhdueshëm në këtë zonë. Ky program ka për qëllim t'i sjellë përfitime afatgjata komunitetit. Kjo kompani është angazhuar në disa aktivitete, si për shembull: ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanaleve të kullimit si në tokën e kompanisë ashtu edhe në tokën e fermerëve lokalë, sponsorizimi i klubeve të atletëve lokalë, dhurimi i furnizimeve dhe pajisjeve për shkollat fqinje, sponsorizimi dhe dhurimi për organizatat e bamirësisë që trajtojnë kancerin, mbështetje të familjeve në nevojë që jetojnë me asistencë, sipërmarrja e projekteve të ndryshme pilote, si praktikatat më të mira për të krijuar një lidhje me komunitetin.

### c. Mjedisi

Kompania ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përfunduar Vlerësimin Social dhe Mjedisor të fushës së naftës Patos-Marinzë në vitin 2011. Ndërkohë, ajo ka filluar konsultimet publike dhe procesin e informimit me komunitetet përkatëse.

## 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të

Deri tani bashkëpunimi i *Bankers Petroleum Albania Ltd* me NjQV-të përkatëse ka qenë



pozitiv. Shumë nga veprimet e ndërmarra për komunitetin në këtë zonë u diskutuan më parë me NjQV-të dhe përfitues të tjerë.

#### 4. Problemet me të cilat përballen

Varfëria në zonë dhe niveli i lartë i papunësisë tek qytetarët e ka orientuar kompaninë të ndërmarrë projekte specifike me fokus te gratë dhe njerëzit në nevojë. Normalisht njerëzit duhet të bëjnë dallimin mes filantropisë dhe iniciativave të CSR-së.

#### 5. Planet për të ardhmen

Patos-Marinza është një zonë bujqësore. Si e tillë, i vetmi aktivitet që i lejon familjet të mbijetojnë është bujqësia dhe bagëtia. 80% e popullsisë jeton dhe kujdeset për familjet e tyre duke u marrë me bujqësi. Duke qenë në dijeni të këtij fakti, *Bankers Petroleum Albania Ltd.* po punon për të hartuar një program të veçantë për ta bërë sektorin e bujqësisë të qëndrueshëm.

### 5.1.3 Sektori i çimentos

#### Antea Cement Sha - Titan Group

##### 1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti

*Titan* është investimi i huaj privat më i madh në vend deri tani dhe një nga investimet më të mëdha të *Titan Group* gjatë viteve të fundit në Shqipëri, me një vlerë prej 200 milion eurosh. Kompania ka filluar procesin e ndërtimit të fabrikës së çimentos në Shqipëri që në vitin 2005. Vizioni i kompanisë për CSR-në ka për qëllim të identifikojë, vlerësojë, menaxhojë dhe përmirësojë fushat që kanë lidhje me këtë sektor. Kompanisë i është dhënë një “Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Përgjegjësisë Sociale” nga kompania evropiane për inspektim dhe certifikim, S.A, në vitin 2009.

Në fund të vitit 2005, grupi menaxhues i kompanisë mori vendimin të kërkonte për një vend, pranë burimeve të materialeve të nevojshme të papërpunuara, për të ndërtuar një fabrikë për prodhimin e çimentos në Shqipëri, në mënyrë që të plotësoheshin nevojat e vendit gjithnjë e më shumë në rritje për materiale ndërtimi. *Titan* ka eksportuar thasë çimentoje në tregun shqiptar nga viti 1994 deri në vitin 2006, kur ajo ndërtoi një qendër të madhe për shpërndarjen e çimentos në Vlorë (e cila vazhdon veprimtarinë e saj edhe sot).

Një marrëveshje u nënshkrua mes kompanisë shqiptare *Antea Cement sh.a.*, degë e *Titan Group* dhe kompanisë kineze *CBMI Construction Co. Ltd.*, për të ndërtuar një fabrikë të re për prodhimin e çimentos në 25 korrik 2007 në Tiranë. Mes datave 23 korrik dhe 1 tetor 2007, parlamenti shqiptar ratifikoi një marrëveshje mes *Titan Group* dhe autoriteteve kombëtare për ndërtimin e një fabrike për prodhimin e çimentos në vendin e quajtur Boka e Kuge në rajonin e Krutës (50 km në veri të Tiranës). Në këtë mënyrë, *Titan* siguroi të drejtën për përdorimin e tokës dhe të drejta për shfrytëzimin e minierave për 99 vjet.

Puna për ndërtimin e saj filloi në shkurt të vitit 2008. Disa muaj më vonë, në nëntor të vitit 2008, u deklarua se IFC-ja dhe BERZH-i do të merrnin një pjesë të aksioneve të *Antea Cement sh.a.* Prodhimi i klinkerit të parë daton në janar të vitit 2010, ndërkohë që shitjet e para të çimentos si për tregun vendas ashtu edhe për eksport u regjistruan në prill të vitit 2010.

## 2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së

Parimet e përgjegjësive sociale të korporatave dhe të zhvillimit të qëndrueshëm janë përfshirë në strategjinë dhe praktikën e biznesit të *Titan Group*, duke i dhënë rëndësi maksimale sigurisë në punë, reduktimit të ndikimit të veprimtarisë së saj te mjedisi, kontributit për mirëqenien e punonjësve të saj dhe komuniteteve lokale fqinje.

Në këtë kontekst, komunikimi transparent dhe dialogu i sinjertë janë thelbësorë për të krijuar besim dhe bashkëpunim reciprok me të gjithë aktorët e interesuar (punonjësit, komunitetet lokale, klientët, aksionerët, organizatat joqeveritare, etj.).

Angazhimi i *Titan Group* për CSR-në dhe Zhvillim të Qëndrueshëm mund të tregohet më mirë përmes vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra gjatë krijimit dhe fillimit të veprimtarisë së kompanisë në Shqipëri. Plani i zbatimit për të gjithë projektin (vendosja dhe zhvillimi i prodhimit dhe aktiviteteve tregtare në rajon) u shoqërua nga një studim i veçantë për ndikimin social dhe mjedisor, duke qenë se kjo ishte hera e parë që aktivitete të tilla kryheshin në këtë zonë.

Parimisht, kompania ishte e fokusuar në tre komponentë kryesorë: praktikën e punës, standardi SA 8000 për Burimet Njerëzore dhe standardet ndërkombëtare. Gjatë dhjetorit 2012, kompania informoi përmes medias se kompania *Antea Cement sh.a* ishte certifikuar sipas SA 8000. Kompania kishte kaluar në mënyrë të suksesshme procesin e auditimit dhe tani ajo është kompania e parë në Shqipëri e certifikuar me këtë standard.

### a. Stafi/Punonjësit

Ndërtimi nuk është shoqëruar nga asnjë rast aksidenti. Më shumë se 4 milion orë pune u kryen në siguri absolute. Kompania punon shumë për të ofruar siguri në punë. Ekziston shërbimi i ambulancës 24 orë, si dhe një mjek në shërbim për çdo rast aksidenti apo sëmundjeje nga personeli.

Kompania zbaton një kod sjelljeje korrekt në punë si për punonjësit ashtu edhe për pushimin nga puna, nëse ka ndonjë rast të tillë. Gjithashtu, është krijuar një sindikatë e punonjësve me përfaqësues të brendshëm të punëdhënësve dhe punonjësve në masën 50% me 50%. Sindikata e punonjësve ka një marrëveshje kolektive me *Titan Group*.

Që nga fillimi i aktivitetit të saj, lidershipi i kompanisë identifikoi aktorët e interesuar, dhe në varësi të kësaj, krijoi komitetin e brendshëm për rekrutimin e punonjësve. Aktualisht, kjo kompani ka punësuar më shumë se 210 punonjës. Për më tepër, kompania ka nënkontraktuar disa herë edhe persona të tjerë. Është zhvilluar një program trajnimi i vazhdueshëm për punonjësit gjatë procesit të punësimit të tyre, përveç trajnimit në punë që ofrohet nga stafi.

### b. Komuniteti

Një plan social tre-vjeçar është miratuar për të nxitur zbatimin proaktiv të procedurave dhe sistemeve për të kufizuar dhe kontrolluar ndikimin e fabrikës te komunitetet lokale dhe mjedisi.

Puna në fabrikë ka vazhduar në harmoni me një sërë iniciativash të CSR-së për të financuar dhe mbështetur punën e Qendrës së dytë në Shqipëri për Akreditimin e Trajnimeve Profesionale Teknike, duke ofruar seminare të specializuara. Kompania promovon dialogun me komunitetin dhe bashkitë e zonës për të shkëmbyer ide për

zhvillimin e zonës. Ajo gjithashtu ka kompensuar në para pronarët e tokës që përdoret nga ky investim.

Kompania ka hapur një shkollë profesionale në komunën e Thumanës. Personeli profesional që arsimohet atje mund të jetë personel potencial i *Titan Group* në të ardhmen. Kompania ka investuar edhe për transportin e produkteve të saj.

### c. Mjedisi

Një ndër aspektet më të rëndësishëm të fabrikës së re, për të mos thënë më i rëndësishmi, është fakti që ajo ofron një shembull të praktikës së mirë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Që nga fillimi i projektit, *Titan Group* krijoi një komitet drejtuesish të lartë për të koordinuar dhe bashkëpunuar me kontraktorët dhe furnitorët, dhe për të siguruar që konstruksioni të kryhet në përputhje me standardet e larta të *Grupit*. Sisteme të veçanta menaxhimi janë krijuar për shëndetin dhe sigurinë, operacione dytësore për furnizim të përgjegjshëm dhe për mbrojtjen e mjedisit. Vlen të përmenden elementët e mëposhtëm:

- Një Sistem Gjithëpërfshirës për Menaxhimin e Mjedisit, në përputhje me serinë e standardeve ISO 14001
- Një Sistem për Menaxhimin e Përgjegjësive Sociale, sipas standardit SA8000
- Një Sistem për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë, ku përfshihet ndërtimi i fabrikës së re dhe siguria në rrugë.

Fabrika e re është një nga fabrikat me teknologjinë më të përparuar në botë, me tre mullinj vertikalë Loesche për të bluar materialet e papërpunuara, lëndë djegëse e ngurtë dhe çimento, para-ngrohës 5 fazash me djegie, ftohësi i ri i klunkerit, *Claudius Peters*, dhe pajisje paketuese dhe mbështjellëse me kapacitet të lartë *Ventomatic*. Kapaciteti prodhues i fabrikës parashikohet të arrijë deri në 1,5 milionë tonë çimento në vit. Pavarësisht faktit se ky ishte një projekt për fushat e gjelbëra, i ndërtuar në një zonë ku mungon infrastruktura bazë (rrugët, energjia, uji, etj.), në kushte shumë të vështira dhe ku komuniteti përreth nuk kishte asnjë përvojë industriale, puna ndërtimore u përfundua brenda afatit dhe sipas buxhetit të përcaktuar.

### 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të

Sipas ndarjes administrative, kompania kryen aktivitetin e saj në komunat e Thumanës dhe Borizanës, dhe ajo bashkëpunon ngushtë me këto komuna.

### 4. Problemet me të cilat përballen

Kompania nuk është përballur me ndonjë problem të madh, i cili vlen të raportohet.

### 5. Planet për të ardhmen

Kompania ka kryer një studim mjedisor të zonës dhe ka për qëllim të krijojë një histori pozitive në këtë zonë, duke e përcaktuar qartë zonën në të cilën do të ndërhyjë në të ardhmen. Kjo do të ketë një ndikim pozitiv në komunitet. Faktori mjedis dhe gjelbërimi janë në fokus të kësaj sipërmarrjeje. Sipas ligjit, kompania duhet të pyllëzojë 250 ha tokë pyjore, gjë që po realizohet plotësisht. Në iniciativat e fundit, kompania po merret me krijimin e një rrjeti për CSR-në, duke përfshirë aktorët kryesorë të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, median, etj. Ky rrjet do të jetë një strukturë vullnetare, ku të gjithë anëtarët duhet të kontribuojnë në natyrë.

## Fushe-Kruja Cement Factory

### 1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti

Kompania ka patur si qëllim tregtimin e çimentos në Shqipëri që në vitin 1994, por ajo u bë funksionale vetëm në vitin 1996 me krijimin e kompanisë *Seament Albania* në Durrës. Kompania e zgjeroi aktivitetin e saj në Elbasan në vitin 1997 dhe më vonë në Fushë-Krujë. Fabrika e çimentos në Fushë-Krujë u ndërtua në vitin 2000 kur kompania me bazë në Liban, *Seament Holding*, siguroi asetet e Sipërmarrjes për Prodhimin e Çimentos në Fushë-Krujë nga qeveria shqiptare. Në vitin 2004, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (*International Finance Corporation* - IFC) firmosën një kontratë huamarrjeje prej 60 milion dollarësh për të financuar zbatimin e linjës së re të prodhimit të çimentos me një kapacitet vjetor prej 1,3 milion tonësh.

Disa nga vlerat e kompanisë së çimentos në Fushë-Krujë janë: disiplina, transparenca dhe barazia.

### 2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së

Duke qenë se kompanisë i është dhënë një kredi nga Korporata Ndërkombëtare Financiare dhe BERZH-i, nuk është e nevojshme të themi se janë marrë në konsideratë masat që lidhen me CSR-në. Janë zhvilluar mjete të ndryshme si: krijimi i Fondacionit Cedar – një OJQ që ka për synim të ndihmojë të varfërit, të sëmurët dhe njerëzit e moshuar duke u ofruar atyre një ndihmë financiare mujore prej rreth 50 eurosh për person, bazuar në nevojat dhe kërkesat e njerëzve, sponsorizimi i arsimit të banorëve të komunitetit, si diploma universitare ashtu edhe mastera, ndërtimi i një palestere për departamentin e policisë në Tiranë, si dhe kontribut për pyjet dhe zonat e gjelbëruara.

#### a. Stafi/Punonjësit

Grupi numëron në total rreth 650 punonjës (380 prej të cilëve janë punësuar në Fushë-Krujë), si dhe rreth 200 persona nënkontraktohen për shërbime të ndryshme.

Kompania ka përcaktuar kodin e saj të sjelljes, i cili është pjesë e paketës së kontratës që i ofrohet personelit të saj. Në të njëjtën kohë, për këtë çështje është arritur një marrëveshje dhe me sindikatën e punonjësve. E njëjta gjë vlen edhe për pagat, për të cilat gjithashtu negociohet dhe bihet dakord me sindikatën. Për shembull, paga minimale e një punonjësi të patrajnuar llogaritet rreth 35.000 lek.

Kompania ka firmosur një kontratë kolektive me sindikatën, si dhe ka krijuar një zyrë për përfaqësuesin e sindikatës brenda fabrikës për të siguruar që kompania po pajtohet dhe po sillet në përputhje me ligjin dhe rregullat përkatëse. Për më tepër, ajo ofron bonuse për punonjësit e saj në fund të vitit. Programet vjetore përfshijnë trajnime dhe kurse të specializuara për stafin teknik, sipas nevojave të kompanisë.

Për më tepër, ka fleksibilitet në punësimin e personave me kohë të pjesshme, të cilët vazhdojnë universitetin, dhe pasi janë diplomuar bëhen staf me kohë të plotë në pozicione më të mira, si për shembull, inxhinierë.

#### b. Komuniteti

Në përgjithësi kompania ka krijuar marrëdhënie të mira me komunitetin, përveç rasteve me disa individë të veçantë. Nuk ka patur përpjekje për të negociuar apo diskutuar me

komunitetin në rastet kur ka patur probleme (si bombardimet apo bllokimi i rrugëve). Administratori i kompanisë deklaroi se nuk ka një dallim të qartë dhe transparencë se kush është komuniteti në të vërtetë. Megjithatë, kompania ka riparuar dëmtimet (e shkaktuara nga persona të ndryshëm) brenda territorit të fabrikës, por jo ato që janë shkaktuar te hekurudha, duke qenë se ajo konsiderohet hapësirë publike dhe kompania nuk ka të drejtë të ndërhyjë në atë zonë.

Pavarësisht kësaj, kompania po nxit punësimin nga komuniteti lokal, gjë që nënkupton se rreth 250 njerëz nga komuniteti përreth janë punësuar në këtë fabrikë.

Për më tepër, me komunitetin janë aplikuar edhe nënkontraktime të tjera, si për shembull në fushën e sigurisë dhe transportit. Përvoja e fundit ka qenë e mirë, në kundërshtim me përvojën e mëparshme.

### c. Mjedisi

Fabrika në Elbasan sapo ishte privatizuar, dhe kompania ka investuar tashmë në filtrat e pastrimit dhe paketimit, gjë që tregon angazhimin e saj për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të komunitetit. Fabrika e Fushë-Krujës është shkatërruar dhe rindërtuar nga fillimi me ndihmën e kredisë nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare. I njëjti sistem filtrimi iu dha edhe fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë dhe asaj në Elbasan. Ky mund të konsiderohet si një shembull i praktikave më të mira.

Kompania gjithashtu ka zbatuar një teknologji moderne në lidhje me monitorimin e tymrave që lëshohen përmes instalimit të makinerive që tregojnë parametrat e nevojshëm.

Çimentoja që prodhohet në fabrikën e Fushë-Krujës është një produkt jo i rrezikshëm, i cili përputhet me standardet përkatëse evropiane për materialet e ndërtimit. Produkti është certifikuar me standardet CE dhe ISO. Një komitet sigurie është krijuar në zyrën e sindikatës që ndodhet në fabrikë, për të rishikuar dhe kontrolluar performancën e fabrikës.

Gjithashtu ekziston një komitet energjie, i cili është mjaft aktiv dhe shpesh organizon diskutime se si mund të ruhet energjia, si të vendosen përparësi për ide të ndryshme dhe si të realizohen ato.

Kompania po merr në konsideratë gjithashtu përdorimin e menaxhimit të mbeturinave si një burim energjie në të ardhmen, duke marrë parasysh se menaxhimi i mbeturinave është një çështje mjaft e nxehtë në vend. Fabrikat e çimentos janë furrat më të mira të djegies në botë, duke qenë se temperatura në të cilën ato veprojnë arrin në 1.400 gradë celsius, ndërkohë që temperatura e furrave të zakonshme të djegies arrin në 1.000 gradë celsius.

### 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë lokale dhe OJQ-të

Kompania e çimentos në Fushë-Krujë paguan të gjitha detyrimet e saj financiare vjetore, të cilat në total arrijnë një vlerë rreth 200.000 euro. Kompania ka aplikuar për marrjen e një licëse për një furrë për djegien e mbeturinave, por ajo nuk është lëshuar ende. Kompania po pajtohet me standardet e kërkuara dhe çdo vit ajo i dorëzon Ministrisë së Mjedisit një raport monitorimi mbi shkallën e emetimit.

Për më tepër, menaxheri i komunitetit i është drejtuar kryetarit të bashkisë së Fushë-

Krujës, dhe ka kërkuar lejen e tij për të pastruar mbeturinat në zonën e varrezave, por kjo kërkesë është refuzuar nga kryetari i bashkisë.

#### *4. Problemet me të cilat përballen*

Në Durrës kompania kryen veprimtarinë e saj brenda portit, e për pasojë nuk ka asnjë problem me komunitetin. Fushë-Kruja mbetet një zonë problematike, duke qenë se ka pak individë (të cilët gjithashtu janë të punësuar në fabrikë) që janë kundër saj dhe herë pas herë kryejnë sulme të ndryshme, si bombardim të mureve të fabrikës apo të hekurudhës, apo bllokim të rrugëve. Këto veprime kanë qenë mjaft të shpeshta që nga viti 2001. Kontraktimi i komunitetit lokal për Sigurinë Private ka rezultuar në një përvojë të keqe për kompaninë.

Aktualisht transporti kryhet përmes kamionëve të klientëve sepse kompania është përballur me probleme të shumta (bombardime) gjatë kohës kur përdorte hekurudhën. Trajtimi i barabartë i burrave dhe grave, siç është këshilluar nga eksperti i Korporatës Ndërkombëtare Financiare, ka qenë i vështirë për shkak të mentalitetit të komunitetit, por kompania po përpiqet ta kapërcejë atë.

#### *5. Planet për të ardhmen*

Kompania ka në plan të përmirësojë sistemin monitorues të shkallës së emetimit përmes një roboti, të analizojë cilësinë e ajrit dhe të djetë mbeturinat në furrë pasi të jetë lëshuar leja përkatëse.

### 5.1.4 Sektori i hidrocentraleve

#### **Energy Ashta shpk**

##### *1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti*

Në vitin 2008, kompania filloi fazën e planifikimit të hidrocentralit të Ashtës në Bushat të Shkodrës në mënyrë që të arrihej marrëveshja koncesionare. Për ta bërë këtë u deshën afërsisht 15 muaj.

##### *2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së*

###### **a. Stafi/Punonjësit**

Për rekrutimin e stafit, kompania ka përdorur modelin e kontratës për punësime të brendshme. Deri tani, 25 persona ishin punësuar si staf i brendshëm, por për ndërtimin e fabrikës u nënkontraktuan kompani lokale, duke punësuar kështu edhe më shumë persona në mënyrë jodirekte. Në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të Ashtës, kompania vepron në bazë të standardeve evropiane dhe të gjithë punonjësit informohen për planin shëndetësor dhe atë të sigurisë. Çdo punonjës merr trajtime shëndetësore, veshje mbrojtëse në punë dhe pajisje. Numri i aksidenteve është shumë i ulët: tetë nga 1 milion orë pune (krahasuar me sektorin e ndërtimit ku shkalla është 60 aksidente për 1 milion orë pune). Kompania ofron sigurime shoqërore sipas ligjit dhe Kodit të Punës për punonjësit e saj, sigurime në raste aksidentesh, si dhe sigurime shëndetësore me bazë vullnetare. Ajo gjithashtu ofron ndihmë ushqimore.

###### **b. Komuniteti**

Në janar të vitit 2009, kompania ka organizuar dëgjesa publike në zonën e mbuluar nga projekti, ku u ftuan përfaqësues të komunave lokale, qytetarë dhe njerëz të tjerë të

rëndësishëm. Qëllimi i këtyre takimeve ishte organizimi i konsultimeve mes aktorëve të interesuar dhe prezantimi i projektit për aktorët lokalë të interesuar. Vetë Ministria e Ekonomisë ka bërë disa konsultime të avancuara në vitin 2007.

U organizuan 3 takime për të informuar publikun. Gjithashtu, u krye edhe një studim urban i zonës, ndërkohë që u mor edhe leja mjedisore nga autoritetet. Projekti është zhvilluar nën Mekanizmin për Zhvillim të Pastër të UNFCCC-së (*United Nations Framework Conventional Climate Change*). Fabrika parashikohet ta fillojë aktivitetin e saj në mars 2013.

Në pranverë të vitit 2009, kompania vuri në dispozicion të komunitetit një numër telefoni, ku ata mund të ofronin informacion në lidhje me këtë projekt dhe ndikimet e tij. Për më tepër, kompania ka bërë fushatë për fabrikën në gazetat e përditshme, dhe ajo mund të kontaktohet përmes internetit në faqen e saj zyrtare.

Qëllimi afatgjatë i kompanisë është krijimi i një klime (atmosfera) të mirë fqinjësisë në zonë duke qenë se marrëveshja koncesionare është 35-vjeçare dhe kompania dëshiron t'i mbajë premtimet që ka bërë.

### c. Mjedisi

Ndërtimi ka filluar në vitin 2010 dhe që nga ajo kohë, kompania ka monitoruar nga afër çdo aspekt të ndikimit në mjedis, dhe për këtë ajo ka angazhuar një agjenci lokale për mjedisin.

Me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, kompania ka organizuar programe trajnimi 6-mujore për punonjësit e saj, përfshi këtu trajnime bazë dhe trajnime teknologjike që kanë lidhje me këtë sektor (trajnime në vendin e punës) për ekspertët, pozicione të nivelit të lartë brenda kompanisë.

### 3. Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të

Kompania ka luajtur rolin e ndërmjetësit mes qeverisë dhe komunitetit. Gjithashtu, ajo është lidhur me ekspertë të mjedisit për të marrë vlerësime jo të drejtpërdrejta nga komuniteti në lidhje me çështje të ndryshme gjatë fazës së ndërtimit.

Përveç kësaj, në lidhje me krijimin e kontakteve dhe dialogut me autoritetet lokale, kompania ka organizuar takime të rregullta me kryetarin e bashkisë së Bushatit dhe Vaut të Dejës. Qëndrimi i tyre ndaj hidrocentralit të Ashtës është shumë pozitiv.

Rehabilitimi i pyjeve dhe zonës është një detyrim i përcaktuar në ligj. Kompania angazhoi ekspertë të pavarur për të analizuar mjedisin dhe për të sugjeruar se si mund të mbilleshin më shumë pemë në këtë zonë.

### 4. Problemet me të cilat përballen

Çështja e pronësisë vazhdon të mbetet një problem. U organizuan takime për t'iu përgjigjur ankesave të tyre, dhe për të trajtuar dhe zgjidhur këto probleme/çështje.

### 5. Planet për të ardhmen

Tre avantazhet kyçe të kompanisë do të jenë:

- Pagesa e një vlere të mirë taksash për komunitat
- Ripyllëzimi i zonës
- Ndikim pozitiv për prodhimin e energjisë së gjelbër në vend.

Në vitin 2008, kompania filloi fazën e planifikimit të hidrocentralit të Ashtës në Bushat të Shkodrës në mënyrë që të arrihej marrëveshja koncesionare. Për ta bërë këtë u deshën afërsisht 15 muaj.

## **Devoll Hydropower sh.a**

### *1. Histori e shkurtër dhe aktiviteti*

*Devoll Hydropower sh.a* është një kompani shqiptare me sipërmarrje të përbashkët mes kompanisë austriake *EVN AG* dhe kompanisë norvegjeze *Statkraft AS*. Në mars 2013, *EVN AG* i shiti aksionet e saj të *Statkraft AS*, e cila u bë aksionereja e vetme e projektit. Kompanisë iu dha një marrëveshje koncesionare nga qeveria e Shqipërisë për të ndërtuar, zotëruar, drejtuar dhe transferuar tre hidrocentrale në lumin e Devollit. Kjo marrëveshje u ratifikua nga parlamenti shqiptar dhe hyri në fuqi më datë 1 prill 2009. Projekti për hidrocentralin e Devollit do të ketë të instaluar një kapacitet total prej afro 280 MW. Projekti konsiston në tre hidrocentrale dhe rezervuare në Banje, Kukel dhe Moglice. Ai ka tre faza: faza parandërtimore, kërkimi dhe studimi; faza e ndërtimit dhe faza e funksionimit. Kompania është ende në fazën e parë. Ndërtimi pritet të fillojë në vitin 2013 dhe koha e planifikuar për ndërtimin është afërsisht 6 vjet.

### *2. Ndikimi dhe arritjet e CSR-së*

#### **a. Stafi/Punonjësit**

Deri tani kompania ka punësuar 23 punonjës, por ka në plan të punësojë deri në 60 persona në periudhën afatgjatë. Kompania ka punësuar kryesisht staf të kualifikuar lokal në Gramsh. Për ndërtimin e hidrocentralit, kompania do të nënkontrakttojë si kompani të huaja ashtu edhe lokale, e për pasojë në mënyrë indirekte do të punësojë më shumë njerëz. Edhe menaxheri i komunitetit është punësuar nga zona lokale. Të gjitha vendet vakante për të plotësuar nevojat e kompanisë bëhen publike dhe reklamohen në gazeta dhe në faqen e internetit të kompanisë: [www.devollhydropower.al](http://www.devollhydropower.al)  
Kompania ka organizuar kurse anglishteje falas për stafin me kualifikim mesatar.

#### **b. Komuniteti**

*Devoll Hydropower sh.a* përpigjet të ofrojë informacion të përditësuar për të gjithë aktorët e interesuar dhe palët e tjera të interesuara përmes mekanizmeve të ndryshëm që janë vendosur nga kompania. Kompania gjithashtu përditëson rregullisht faqen e saj të internetit për të ofruar informacionin e fundit për të gjithë aktorët e interesuar dhe për të qenë sa më transparent të jetë e mundur.

Kompania ka hartuar, publikuar dhe shpërndarë fletëpalosje me informacion të ndryshëm mbi aktivitetet e projektit, rivendosjen, çështjet e shpronësimit, si dhe mekanizmin për trajtimin e ankesave, në mënyrë që të gjithë aktorët e interesuar të informohen plotësisht.

Kompania ka ndryshuar planifikimin fillestar të digës prej 100 m në 80 m të lartë në mënyrë që të shmangë përmbytjet e më shumë zonave që rrethojnë bregun e lumit Devoll.

Lista e shpronësimeve të familjeve të prekura është përgatitur dhe është bërë publike.

Në mënyrë që të informohen dhe të merret informacion nga qytetarët për zhvillimin e projekteve të ardhshme, kompania ka krijuar një mekanizëm për trajtimin e ankesave. Përmes këtij mekanizmi, cilido që ka një ankesë apo shqetësim për aktivitetet e



projektit, mund t'i bëjë të ditur kompanisë mendimin e tij/saj, në mënyrë që kompania ta adresojë këtë shqetësim në mënyrë të përshtatshme. Të gjithë aktorët e interesuar mund të dorëzojnë mendimet e tyre duke plotësuar një formular vlerësimi, në telefon apo personalisht. Të gjitha ankesat adresohen brenda një jave. Ky mekanizëm është krijuar duke njohur rëndësinë e transparencës dhe përgjegjshmërisë. Për këtë arsye, ky mekanizëm përdoret jo vetëm me qytetarët, por edhe me autoritetet lokale dhe me aktorë lokalë të tjerë të interesuar.

Tre dëgjesa publike u organizuan gjatë 2011-12 në Gramsh, Moglice dhe Kutallare. Dëgjësata publike organizohen sipas praktikave më të mira të ofruara nga organizatat ndërkombëtare.

Kompania ka hapur dy qendra për informim publik në Gramsh dhe Nikollare. Qytetarët janë ftuar shpesh nga kompania dhe janë përdorur autobusë për t'i mbledhur ata në tryeza të rumbullakëta, të cilat organizoheshin për t'i informuar qytetarët për projektin, ndikimin e tij në këtë zonë dhe ndikimin që do të ketë pas largimit të familjeve. Do të ketë afërsisht 2.000 familje që duhet të largohen nga toka apo shtëpitë e tyre për shkak të përmblyjeve të shkaktuara nga tre hidrocentralet që do të veprojnë në këtë zonë pasi periudha për ndërtimin e tyre, 5-7 vjet, të ketë përfunduar.

Kompania organizon rregullisht Sesione Informuese të Lëvizshme në zonën e projektit në mënyrë që t'i informojë komunitetet e prekura.

Kompania ka përgatitur planin e rivendosjes për të gjitha familjet e prekura duke u bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ky plan do të jetë i disponueshëm për publikun në fund të vitit 2013. Për më tepër, kompania ka shpërndarë një pyetësor të të gjitha familjet e prekura për të analizuar mendimet e tyre dhe nevojat përkatëse në lidhje me përfitimet nga shpronësimi.

Si pjesë e politikës së brendshme të kompanisë, ajo ka krijuar gjithashtu një zyrë ligjore për të kontrolluar dhe asistuar qytetarët në të gjitha çështjet që lidhen me rivendosjen e tyre.

Për më tepër, kompania po merr në konsideratë dhënien e paketave të kompensimit bujqësor si një element i rëndësishëm për të përmirësuar kushtet e jetesës për personat e prekur nga projekti.

### c. Mjedisi

Projekti i Devollit është zhvilluar nën Mekanizmin për Zhvillim të Pastër nën Protokollin e Kiotos. Kompania ka aplikuar dhe i janë dhënë licencat përkatëse, si për shembull leja për përdorimin e ujit, deklarata e moskundërshtimit arkeologjik dhe leja teknike për digat Banje, Kokel and Moglice. *Devoll Hydropower sh.a* ka zhvilluar plane zbatimi për mjedisin dhe aktivitetet sociale, përfshi këtu: Plani për Menaxhimin e Mjedisit, Plani për Zhvillimin Social dhe Plani i Veprimit për Rivendosjen. Këto plane, të cilët përfshijnë një inventar socio-ekonomik të zonës, kryhen nga një grup ekspertësh të pavarur të kualifikuar.

Gjithashtu, është kryer një studim bujqësor në hidrocentralin e Banjes nga ekspertë të pavarur, i cili ka patur për qëllim të vlerësojë ndikimin e projektit në këtë zonë dhe të identifikojë mundësitë për të shtuar efikasitetin e burimeve ekzistuese.

Duke qenë se kompania është financuar në mënyrë të barabartë nga dy aksionerët e saj (nuk janë marrë hua), menaxhuesit e saj përipiqen të plotësojnë standardet e kërkuara dhe të monitorojnë në masën më të mirë të mundshme të gjitha çështjet që lidhen me ndikimin social dhe atë mjedisor.

### 3. *Bashkëpunimi me NjQV-të, qeverinë qendrore dhe OJQ-të*

Qeveria lokale është konsideruar gjithmonë një partner i fuqishëm për kompaninë, pavarësisht faktit se është një organ përfitues nga *Devoll Hydropower sh.a.* Kompania organizon rregullisht tryeza të rumbullakëta me autoritetet lokale, të cilat kanë qëllim informues. Për më tepër, një herë në dy – tre muaj organizohen takime mes drejtuesve më të lartë (FEO, CTA) të kompanisë dhe njësive të qeverisjes lokale, komunitetit, shoqërisë civile dhe OJQ-ve që trajtojnë çështjet e mjedisit.

### 4. *Problemet me të cilat përballen*

N/A

### 5. *Planet për të ardhmen*

Projektet kryesore për të ardhmen përfshijnë:

- *Devoll Hydropower sh.a* do të përditësojë plotësisht Planin e saj për Menaxhimin Mjedisor dhe Social, si dhe Planin e Veprimit për Risistemimin brenda vitit 2013. Për më tepër, në vijim të inventarit socio-ekonomik të zonës, gjatë konsultimeve me publikun kompania do të prezantojë një Matric të Përfitimeve, ku do të përcakohen kriteret për alternativat e përshtatshme dhe përfitimet nga *Devoll Hydropower sh.a.*, kompensimet (në natyrë) dhe procesi i rivendosjes. Aksesi në tokë (pas Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave) do të zbatohet dhe pagesat për kompensim do t'u jepen pronarëve. Planifikimi dhe rindërtimi i infrastrukturës zëvendësuese do të zbatohet nga Grupi i Punës Institucionale, i cili është pjesë e qeverisë shqiptare. Infrastruktura ekzistuese, e prekur nga rezervuari i Banjes (si për shembull shkolla 9-vjeçare e Drizes) nuk do të shkatërrohet përpara se infrastruktura zëvendësuese të përfundojë.
- Kompania do të marrë përsipër kryerjen e punës përgatitore në Banje, përfshi këtu rehabilitimin/ndërtimin e një linje për furnizim me energji elektrike 35 kV, mjete komunikimi dhe përmirësimin/krijimin e rrugëve, si për shembull *bypass*-i i rrugës ekzistuese që lidh Gramshin me Cërrikun. Gjithashtu, kompania do të vazhdojë të rekrutojë staf të kualifikuar nga zonat përreth.

## 5.2 AKTORËT KRYESORË

### 5.2.1 Qeveria qendrore

#### **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**

Ekzistojnë 3 drejtori politikë-bërëse dhe 3 drejtori ekzekutuese në ministri. Ky informacion është siguruar nga Drejtoria e Politikave të Inspektimit dhe Marrëdhënive të Punës.

Duhet theksuar se nuk ka politika të veçanta që lidhen me CSR-në në Ministrinë e Punës, megjithatë ministria përgatit studime mbi sipërmarrjet dhe analiza vjetore.

Dokumentat dhe rregullat kryesore që lidhen me CSR-në janë: Kodi i Punës, Puna, Shëndeti dhe Siguria, legjislacioni që lidhet me këtë çështje (ligjet dhe aktet nënligjore). Pajtimi me ligjin e punës dhe legjislacionin shqiptar që lidhet me këtë çështje kërkon përgjegjësi sociale. Informacioni dhe të dhënat statistikore mund të gjenden në faqen e internetit të Inspektoratit të Punës: [www.sli.gov.al](http://www.sli.gov.al) si dhe te shërbimi kombëtar i punësimit.

Ndonjëherë ministria luan një rol ndërmjetës për çështje dhe raste të ndryshme në bashkëpunim me sindikatat respektive; vlen të përmendet rasti i kompanisë *Albanian Chrome – ACR* apo i kompanisë së çimentos në Fushë-Krujë.

Sindikatat po luajnë një rol të rëndësishëm për të mbështetur punonjësit e kompanive. Ato firmosin kontrata kolektive me kompanitë, në mënyrë që të ngrenë zërin në emër të punonjësve dhe t'i përfaqësojnë ata në raste të ndryshme. Sindikatat janë të rëndësishme për të ashtuquajturën paqe sociale, që nga momenti kur firmoset kontrata sociale. Për pasojë, është e rëndësishme që punonjësit e kompanive të ndryshme të organizohen në sindikata.

Bazuar në informacionin e marrë nga ministria, sipas të dhënave statistikore, rreth 80-90% e aksidenteve në vendin e punës ndodhin në miniera (nën tokë) dhe në sektorin e ndërtimit. Inspektorati i Punës ka të drejtën të kryejë kontrolle vetëm mbi tokë, ndërkohë që Departamenti për Inspektimin dhe Ruajtjen e Minierave (RISHMI) është përgjegjës për kontrollin nën-tokësor dhe për kontrollin e kushteve të punës.

Për më tepër, konsulentët u informuan në ministri për rolin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP). Bazuar në statistikat dhe studimin vjetor përkatës<sup>12</sup> të ofruar nga ministria, u zbulua se bazuar në nenin 6/1 të Kodit të Punës, SHKP-ja ofron rregullisht informacion për vendin e punës në mënyrë që të promovojë punësimin. Gjatë vitit 2011, kjo agjenci shpalli 16.074 vende vakante pune. Përveç kësaj, u raportua se u punësuan 12.749 njerëz, 11.556 persona prej të cilëve u punësuan me ndërmjetësimin e agjencisë.

SHKP-ja gjithashtu ofron këshilla profesionale dhe orientime mbi vendin e punës: gjatë vitit 2011, u regjistruan 42.633 persona që kërkonin punë, 54.3% e të cilëve ishin klientë të rinj, ndërsa pjesa tjetër ishin klientë të vjetër. 62% e tyre apo 88.727 persona morën këshillat e nevojshme dhe 202 personave iu siguroa ndihmë përmes klubeve të punës. Gjatë vitit 2012, 3.249 persona që kërkonin punë u orientuan për trajnime profesionale (2.923 persona në qendra publike dhe 326 në qendra private).

Gjithashtu, ka disa programe punësimi, si për shembull: 1) programi për nxitjen e punësimit, 2) programi për pagesat e të papunëve dhe 3) programi për edukim profesional.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 47, datë 16.01.2008, për programin për nxitjen e punësimit përmes trajnimeve në vendin e punës, u ofrua një program trajnimi me kohëzgjatje 2-6 muaj. 26 subjekte kanë trajnuar në punë 553 persona, të cilët kërkonin të punësoheshin (të papunë). Pas përfundimit të trajnimit, 50% e pjesëmarrësve, pra 277 persona, u mbajtën në punë për të paktën një periudhë 6 mujore, siç është përcaktuar në VKM. Shteti është i detyruar të subvencionojë koston e programit të trajnimit në nivelin 70% për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe 50% për bizneset e mëdha. Gjithashtu, ai financon 50% të pagës minimale në shkallë kombëtare (10.000 lek) dhe 0.3% të sigurimit në raste aksidentesh në punë për çdo pjesëmarrës në program.

12 Studim Vjetor i përgatitur nga SHKP-ja dhe Ministria e Punës, 2011

Bazuar në VKM-në Nr. 48, datë 16.01.2008, për programin për nxitjen e punësimit përmes punëkërkuesve të papunë në vështirësi, u ofrua një program me një kohëzgjatje prej 12 muajsh. Përmes këtij programi, 33 subjekte kanë punësuar 485 të papunë në vështirësi për një periudhë 12-vjeçare, siç është përcaktuar në VKM, si edhe në kontratën e firmosur mes Zyrës së Punës dhe subjektit aplikues. Programi financon katër paga minimale në shkallë kombëtare (20.000 lek) gjatë muajve të 5-të, 6-të dhe të 11-të, 12-të të programit, si edhe 16.7% të sigurimeve shoqërore për çdo pjesëmarrës. Bazuar në VKM-në Nr. 873, datë 27.12.2006, për masën e financimit, kriterëve dhe procedurave të zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë që kanë një diplomë universitare (të diplomuar në vend apo jashtë shtetit), ekzistonte një program me kohëzgjatje 6 muaj. 43 subjekte ofruan praktikë si në fabrikat publike dhe ato private për 132 të papunë (të diplomuar gjatë 24 muajve të fundit). Programi financon një pagë mujore prej 6.850 lek dhe 0.3% të sigurimeve në raste aksidentesh në punë për secilin nga pjesëmarrësit në program.

Gjithashtu, përmes programit profesional publik, në vitin 2011 u trajnuan rreth 8.700 persona në qendrat publike të të papunëve, të cilët janë regjistruar në zyrat e punës në 10 drejtori rajonale. Sipas edukimit profesional privat, deri në tetor 2011, 243 kompanive iu dha licënca (121 në Tiranë) për të ofruar kurse profesionale. Deri tani, kishte 2.101 persona të certifikuar në kurse profesionale dhe 3.385 persona të certifikuar në kurse joprofesionale.

### **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit**

Informacioni u ofrua nga Drejtoria për Kontrollin e Mjedisit, detyrat e të cilës kanë të bëjnë me kontrollin, inspektimin dhe monitorimin e mjedisit. Kjo drejtori ka nën mbikëqyrje departamentet e mëposhtme: policia e pyjeve, inspektorati i peshkimit dhe inspektorati i mjedisit, i cili monitoron aktivitetet e operatorëve të biznesit. Ministria e Mjedisit ofron informacion për të gjitha kompanitë mbi çështjet që lidhen me CSR-në. Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit është përgjegjëse për dhënien e lejeve mjedisore për operatorët e biznesit. Kjo leje lëshohet vetëm pas konsultimeve publike.

Kompanitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe në rast ndikimi negativ, ato kanë detyrimin ta rehabilitojnë atë sipas programit të parapërcaktuar. Qendra e Licensimit Kombëtar është organi i autorizuar për lëshimin e licënsave për bizneset, dhe ajo mbikëqyr të gjitha procedurat që lidhen me këtë proces. Ministria e Mjedisit ka kaluar përmes një procesi reformues dhe aktualisht ekziston një drejtori e veçantë që trajton çështjen e CSR-së. Informacioni për kompanitë ofrohet nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit, të cilat janë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Inspektorati i Mjedisit ka 12 zyra rajonale, dhe në raste mosrespektimi të rregullave dhe kushteve nga kompanitë, ai ka të drejtë t'i propozojë ministrit anulimin e lejes së lëshuar mjedisore.

Projekte donatore si SELEA po kontribuojnë në zona të ndryshme, një prej të cilave është përcaktimi i parametrave për aparaturat dhe pajisjet në mënyrë që të bëhet një monitorim më i mirë i performancës mjedisore të kompanive. Një nga kompanitë që dallon për zbatimin e mirë të CSR-së është *Titan Group*. Ajo mund të konsiderohet si një investim model.

## Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)

METE po luan një rol koordinues, ajo harton politika mbështetëse dhe legjislacionin për CRS-në, si për shembull rasti i miratimit të Kodit për Qeverisjen e Kompanive për kompanitë e palistruara në dhjetor 2011 me mbështetjen e IFC-së.

METE (përmes Departamentin të Konkurrueshmërisë së Biznesit), së bashku me PNUD-in, kanë ofruar një mbështetje të specializuar në lidhje me çështjet e CSR-së që dy vjet më parë, në lidhje me:

- a. Ndërgjegjësimin e kompanive mbi hapat e nevojshme që duhet të merren në lidhje me CSR-në;
- b. Hartimin dhe lehtësimin e zbatimit të planit kombëtar të veprimit; dhe
- c. Krijimin e grupit të aktorëve të interesuar për CSR-në (përfshi këtu institucionet publike, METE-n, AIDA-n, AKBN-në, Ministrinë e Mjedisit, Dhomën e Tregtisë, Organizatat e Biznesit, ARZH dhe shoqërinë civile).

METE ka luajtur një rol të rëndësishëm për të institucionalizuar një dialog të vazhdueshëm me aktorët e interesuar, veçanërisht gjatë takimeve të forumit të aktorëve shumëpalësh.

Në të njëjtën kohë, ka patur përpjekje për të përcaktuar tregues të matshëm të CSR-së në këtë sektor në nivelin kombëtar. Masa të tjera duhet të merren në mënyrë që ky informacion të merret nga kompanitë. Në këtë aspekt, Instituti i Statistikave do të përfshihet për mbledhjen & përpunimin e të dhënave.

Treguesit e nivelit kombëtar marrin në konsideratë masën e kompanisë, sasinë e xhiros, numrin e punonjësve, etj. Qëllimi është të përcaktojnë treguesit e parë që duhet të maten, e më pas të shtojnë të tjerë hap pas hapi.

Gjatë takimit të forumit kishte diskutime dhe pati ndarje të treguesve sipas sektorit, duke qenë se këta faktorë mund të mos jenë unik dhe të ndryshojnë nga një sektor në tjetrin. Kompanitë me Sipërmarrje të Përbashkët apo kompanitë bija të kompanive të mirënjohura botërore që veprojnë në Shqipëri, të cilat zbatojnë CSR-në, do të ftohen të ndajnë konceptin dhe praktikën e tyre më të mira. Në lidhje me këtë, METE konsideron se *Bankers Petroleum Albania Ltd* dhe *Titan Group – Antea Cement sh.a* mund të jenë të interesuara.

Departamenti i Konkurrueshmërisë nën varësinë e METE-s vepron si një organ koordinues për zbatimin e Planit Kombëtar të hartuar së fundmi. Plani përfshin një plan veprimi dhe është ende në proces për t'u miratuar nga qeveria shqiptare. Aktivitetet e parashikuara për marrëdhëniet me publikun duhet të financohen nga projektet e donatorëve në mënyrë që plani të zbatohet.

Plani Kombëtar i Veprimit për CSR-në parashton një vizion të qartë përmes së cilit Shqipëria promovon CSR-në. Ai mbulon gjashtë dimensionet, si më poshtë:

- 1- Shtim të ndërgjegjësimin si një element kyç të bizneseve të qëndrueshëm në ekonominë moderne
- 2- Vendosja e konsensusit kombëtar për matjen e CSR-së duke përfshirë tregues të përcaktuar mjaft mirë
- 3- Krijimi i një mjedisi favorizues me stimuj të përshtatshëm për përfshirjen e praktikave të CSR-së në sjelljet e biznesit

- 4- Forcimi i përvetësimit të aftësive dhe kompetencave të CSR-së në të gjithë komunitetin e biznesit
- 5- Forcimi i kulturës së informimit, si dhe mbështetja e transparencës dhe raportimit në kohë dhe siç duhet nga kompanitë
- 6- Shpërblimi në rastet e përsosmërisë dhe progresit në lidhje me CSR-në.

Më poshtë përshkruhet ajo që është arritur deri tani në secilën nga gjashtë fushat e Planit Kombëtar, dhe ajo që parashikohet të bëhet gjatë vitit 2013

### *Shtimi i ndërgjegjësimit*

Nën këtë nismë, është ndërmarrë një fushatë për shtimin e ndërgjegjësimit dhe është krijuar një forum shumëpalësh. Në vitin 2013, janë parashikuar disa takime, ku do të diskutohen çështjet që lidhen me CSR-në, diskutime gjithëpërfshirëse, fushata për shtimin e ndërgjegjësimit, si dhe miratimi i Planit të Veprimit për CSR-në nga Këshilli Këshillues i Biznesit.

### *Matja e CSR-së*

- Është kryer një studim mbi treguesit e CSR-së në nivelin kombëtar, sektorial dhe atë të kompanisë
- Janë krijuar grupe pune brenda forumit shumëpalësh
- Janë zhvilluar studime mbi CSR-në në disa sektorë kyç të ekonomisë.

Për vitin 2013, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Hartimi i një studimi bazuar në të dhënat kryesore të treguesve kombëtarë të CSR-së
- Koordinimi rajonal i sistemeve për matjen e performancës kombëtare
- Identifikimi i sektorëve kyç për kryerjen e studimeve/aktiviteteve sektoriale.

### *Mjedisi favorizues*

- Identifikimi i shtysave për kompanitë që janë aktive në çështjet e CSR-së nga grupet e punës ndërministrorë
- Shtysat që promovojnë donacionet e kompanive për OJQ-të apo komunitetet, si dhe krijimi i bizneseve sociale
- Kriteret e CSR-së të integruara në procedurat e prokurimeve publike
- Krijimi i një sistemi grantesh për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme që ndërmarrin praktikatat e CSR-së.

Për vitin 2013, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Takime të shpeshta të grupit të punës ndërministrorë
- Organizimi i diskutimeve gjithëpërfshirëse mbi ligjin për prokurimet publike për të integruar kriteret e CSR-së.

### *Aftësitë dhe kompetencat e CSR-së*

- Ofrimi i sesione të ndryshme të trajnimit dhe mbështetjes mbi çështjet e CSR-së për kompanitë
- Bashkëpunim me universitetet dhe aktorët e tjerë të interesuar për përfshirjen e CSR-së si një komponent të trajnimeve për Qeverisjen e Korporatave
- Bashkëpunim me programe rajonale dhe evropiane për të ndërtuar kapacitete dhe për të ndarë përvojat dhe praktikatat më të mira
- Krijimi i një baze për konsulentët/informacion mbi CSR-në.

Për vitin 2013, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Trajnime për organizatat përfaqësuese të sektorit privat
- Zhvillimi i moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për CSR-në
- Bashkëpunimi me platformat rajonale të CSR-së.

### *Publikimi dhe raportimi*

- Përkthimi dhe promovimi i standardit të raportimit GRI G3
- Diskutime të vazhdueshme me kompanitë e mëdha për të përcaktuar standardin minimal të raportimit në lidhje me ndikimin ekonomik, social dhe mjedisor
- Progres raporti vjetor për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

Për vitin 2013, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Diskutim i forumit për të vendosur një standard minimal për raportimin mbi ndikimin ekonomik, social dhe mjedisor
- Hartimi i raportit vjetor.

### *Çmime për përsosmëri dhe progres*

Në bashkëpunim me aktorët e interesuar, do të vendosen kriteret dhe rregullat për çmimet për CSR-në për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, kompanitë e mëdha, si dhe për bizneset që përdorin metoda novatore.

Për vitin 2013, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Hartimi i udhëzimeve për çmimet për CSR-në
- Organizimi i ceremonisë së parë të ndarjes së çmimeve.

### **Iniciativat e reja të planit përfshijnë:**

- Ndarje të ideve dhe përvojave, dhe krijim të partneriteteve
- Promovimi i filantropisë
- Rrjeti i biznesit
- CSR-ja në industrinë nxjerrëse
- Iniciativat në nivel rajonal.

Po diskutohen stimuj për vitin 2013, të cilët të mund të përfshihen në Strategjinë e vitit 2013, por nuk ka ende asgjë konkrete (mbase ndarja e çmimeve për CSR-në).

### **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)**

Detyra e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore është të ofrojë një panoramë të qartë të biznesit në lidhje me CSR-në. Sipas ligjit, agjencia është përgjegjëse për kryerjen e një kontrolli strikt ndaj kompanive, ndërkohë që pjesa tjetër (bashkëpunimi me bashkitë dhe komunitetin) varet plotësisht nga vullneti i kompanive.

Informacioni i ofruar nga AKBN-ja ndahet në katër sektorët e industrive nxjerrëse. Përsa i përket sektorit minerar, kompanitë duhet të marrin licensat përkatëse në mënyrë që të kryejnë veprimtarinë e tyre. Kompanitë e huaja janë kompanitë më korrekte: ato paguajnë të gjitha detyrimet e tyre dhe respektojnë të gjithë rregullat dhe ligjet. Ndërkohë, kompanitë shqiptare konsiderohen si problematike.

AKBN-ja ka kontakt të drejtpërdrejtë me ministrinë e linjës. Në këtë aspekt, janë hartuar plane zhvillimi vjetore, të cilat negociohen në agjenci dhe më pas miratohen dhe firmosen nga ministria.

Punonjësit kanë firmosur kontratë individuale me kompanitë siç kërkohet nga Kodi i Punës. Sipas ligjit, paga minimale e një minatori duhet të jetë të paktën 40.000 lek. Kompanitë e huaja japin paga më të larta.

Deklarohet se kompanitë kanë detyrimin moral të bashkëpunojnë me autoritetet e qeverisjes vendore. Nuk ekziston ndonjë statistikë në lidhje me iniciativat e ndërmarra nga kompanitë, megjithatë mund të përmenden disa shembuj të mirë nga kompanitë që veprojnë në sektorin e minierave:

- *Tirex Explorations Ltd.* ka investuar në shkolla, rrugë, spitale, kampe; *Beralb* (bakër) ka investuar në shkolla, spitale dhe në bashkinë e Pukës; *Albit Oil* (bitum) ka investuar në një rrugë në Vlorë; *Stone Production* (minierë) ka investuar në një rrugë dhe në ura.
- AKBN-ja ka zhvilluar aktivitete të ndryshme promovuese në qytete të ndryshme dhe këto aktivitete u sponsorizuan nga kompanitë.
- *Albanian Chrome Company* ka qenë mjaft serioze në lidhje me pagat dhe marrëveshje të tjera të ngjashme. Ajo vazhdon të paguajë punonjësit e saj të mëparshëm që nga viti 2008, kur uzina doli jashtë përdorimit. Problemi qëndron në faktin se kompania ka më shumë punonjës se sa nevojitet, gjë që shkakton kosto shumë të mëdha dhe investime.

Agjencia nuk ka përvojë me sindikatat për sa i përket çështjeve që lidhen me CSR-në, përveç rastit të *Albanian Chrome Company* vitin e kaluar. AKBN-ja e konsideron situatën aktuale në Bulqizë shumë serioze.

Sektori i naftës lidhet me fushat e naftës dhe shfrytëzimin e naftës. Ekzistojnë disa marrëveshje hidrokarbure me *Bankers Petroleum Albania Ltd.* *Stream Oil&Gas Ltd.* *Sherwood*, *Petromanas*.

AKBN-ja është përgjegjëse për kontrollin e marrëveshjeve dhe për monitorimin e planit të zhvillimit, përfshi këtu aspektin mjedisor. Plani mjedisor është miratuar nga Ministria e Mjedisit. Përveç rehabilitimit pas fazës së koncesionit, kompanitë e naftës i përmbushin planet e tyre. Marrëveshjet koncesionare janë miratuar me ligj. Ato gjithashtu përcaktojnë rehabilitimin dhe kërkojnë garanci mjedisore (para në dorë) në bankë. Çdo vit, një shumë e caktuar tërhiqet automatikisht nga kjo garanci për rehabilitimin mjedisor.

*Bankers Petroleum Albania Ltd.* është një shembull i mirë, i cili duhet të ndiqet. Kompania është më aktive në fushën e Përgjegjësisë Sociale. Ajo ofron sponsorizime në fusha të ndryshme, si shëndeti i njerëzve, ndërtimi i rrugëve, kabina elektrike, çmime për punonjësit, si dhe trajnime dhe kostot e udhëtimit për stafin e AKBN-së.

Kompania i ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme kushtet e punës dhe teknologjinë për nxjerrjen e naftës (teknologji e përparuar). E njëjta gjë vlen edhe për kompani të tjera të huaja që veprojnë në Shqipëri.

Kompanitë e naftës i kushtojnë gjithashtu vëmendje shëndetit dhe sigurimeve në raste aksidentesh për punonjësit e tyre. Në raste aksidentesh, kompanitë e huaja dëmshpërblejnë palën e dëmtuar. Vlera e sigurimit për shëndetin dhe rastet e aksidentit është 6 milion lek (e cila është edhe sasia e parave që merret nga pala e dëmtuar në rast aksidenti).



Kompanitë private të prodhimit të çimentos nuk varen nga AKBN-ja. Ato arrijnë marrëveshje me komunën apo bashkinë përkatëse ku ato veprojnë. Agjencia Rajonale e Mjedisit kontrollon çështjet që lidhen me mjedisin në këtë aspekt.

Si përfundim, AKBN-ja mendon se ekziston një klimë sociale mjaft pozitive, e cila është krijuar nga kompanitë që kryejnë veprimtarinë e tyre në sektorët e industrisë nxjerrëse. Qëndrimi ndaj mjedisit ka ndryshuar shumë pozitivisht.

AKBN-ja u kërkon kompanive të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në përputhje me standardet. Në shumicën e rasteve, kompanitë kanë arritur më shumë nga sa kërkohet, përfshi këtu rehabilitimin e kushteve të mëparshme të fabrikave. Një shembull është monitorimi i lumin Fan (me SVEKO). Situata që dikur konsiderohej si shumë e keqe dhe problematike, tani ka ndryshuar plotësisht falë rehabilitimit të bërë nga *Beralb Company*.

## 5.2.2 Njësitë e Qeverisjes Lokale

### Bashkia e Patos-it

Në Patos jetojnë thuhetse 35.000 banorë. *Bankers Petroleum Albania Ltd* kryen veprimtarinë e saj në zonën ku, bazuar në ndarjen administrative, përfshihet bashkia e Patosit dhe dy komuna të tjera, ajo e Marinzës dhe Zharrëzës. Kompania ka plotësuar Planin për Integrimin Sektorial për zonën e Patos-Marinzës. *Trans Oil* është një kompani tjetër që vepron në territorin e bashkisë së Patosit. Aktualisht kjo kompani po vendos në punë disa puse naftëmbajtëse.

Sipas kryetares së bashkisë së Patosit, marrëdhëniet e bashkisë me *Bankers Petroleum Albania Ltd* janë të mira në përgjithësi. Kompania ka sponsorizuar krijimin e një parku të gjelbër, me vlerë 17 milion lek. Gjithashtu, ajo ka hartuar një projekt për ujën e pijshëm. Ky projekt do të jetë mjaft i dobishëm duke qenë se bashkia e Patosit e merr ujën e pijshëm 20 kilometra larg, dhe vetëm energjia elektrike për sjelljen e ujit kushton afërsisht 100 milion lek në vit. Pra, investimi do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë të komuniteti.

Aktualisht, Patosi është bërë pjesë e një fenomeni të kohëve të fundit, ku përfshihen dridhjet e tokës apo të ashtuquajturit tërmete. Për shkak të këtyre lëkundjeve të vazhdueshme, në ndërtesa janë krijuar të çara, të cilat janë më të dukshme në zonën e Zharrëzës. Zona nuk konsiderohet si një zonë me ndikim të lartë sizmik, por kohët e fundit ajo është karakterizuar nga këto lëkundje. Në mënyrë që të bëhet një vlerësim i situatës, një komitet u krijua me përfaqësues nga komuniteti, ekspertë lokalë të paanshëm dhe përfaqësues të AKBN-së. Sipas ekspertëve, u kryen disa shpime për nxjerrjen e naftës me anë të shpërthimeve në “të ashtuquajturit xhepat e naftës” (kjo u përdor si një metodë me kosto të ulët, në vend të një metode moderne).

Unionet për mbrojtjen e interesave të qytetarëve nuk janë aspak aktive. Kryetarja e bashkisë së Patosit mendon se komuniteti duhet të diskutojë me përfaqësues të kompanisë në mënyrë që zgjidhë situatën, për shembull, të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar.

Kryetarja e bashkisë thotë: “Sipas ligjit, një pjesë e rentës që *Bankers Petroleum Albania Ltd* i paguan Ministrisë së Financës duhet t’u jepet (25% e vlerës së rentës

10%) bashkive dhe komunave ku kompania kryen veprimtarinë e saj. Bashkia e ka marrë këtë shumë parash për vitin 2011, e cila ishte një shumë mjaft e mirë, thuajse 125 milion lek. Pas verifikimeve të kryera nga Ministria e Financës (sepse ajo u mor nga taksa e doganës), bashkia e Patosit rrezikonte të mos merrte grantin e pakushtëzuar për bashkinë për shkak se ai ishte marrë më përpara si pjesë e rentës së *Bankers*”.

Më vonë kryetarja e bashkisë citoi: *“E di se kohët e fundit është krijuar një Sekretariat për ‘Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse’ dhe anëtarët e tij vijnë nga kompanitë private, akademikë dhe përfaqësues të OJQ-ve që trajtojnë çështjet e mjedisit, por nuk ka asnjë përfaqësues nga komuniteti apo autoritetet lokale. Duhet të përfshihet një zë i fortë i qeverisë lokale në këtë sekretariat”*.

Deri tani, komuniteti as nuk është informuar mbi procesin e privatizimit të sipërmarrjeve shtetërore nga kompanitë private dhe as për ndonjë ndikim pozitiv apo negativ që ky investim i ri mund të ketë si për mjedisin ashtu edhe për komunitetin. Kryetarja e bashkisë ndau informacionin se *Bankers Petroleum Albania Ltd.* ka filluar një program për trajnimin e grave të papuna dhe ka kryer një studim për gjendjen e grave dhe familjeve në nevojë. Ajo tha se këto iniciativa kanë një ndikim pozitiv në komunitet, por kompania duhet të tregojë vazhdimësinë e projektit dhe duhet të merren hapa konkretë, si për shembull punësime apo investime në bujqësi (sepse niveli i papunësisë është mjaft i lartë në bashkinë e Patosit dhe gratë janë thuajse të gjitha të papuna).

### **Bashkia e Fushë-Krujës**

Bazuar në vlerësimin e dhënë nga kryetari i bashkisë së Fushë-Krujës, duket se marrëdhëniet dhe komunikimi me fabrikën e çimentos në Fushë-Krujë nuk kanë qenë shumë të mira për dy arsye: a) pajtimi me detyrimet e taksave dhe b) ndotja e mjedisit.

Kompania nuk i përmbush detyrimet e saj në nivelin institucional, por vetëm në nivelin personal. Bashkia ka vënë një gjobë për stacionin e energjisë elektrike në fabrikën e çimentos. Kryetari i bashkisë citon se deri 1.5 vjet më parë, fabrika e kryente veprimtarinë e saj pa lejen e nevojshme, ndërkohë që tani kjo leje është lëshuar (edhe pse ai dyshon se ajo mund të jetë e falsifikuar).

Sipas kryetarit të bashkisë, nuk ekziston as komunikim as dialog mes kompanisë dhe komunitetit apo bashkisë, duke qenë se kompania nuk është shumë e gatshme të bashkëpunojë me bashkinë.

Ka patur disa konflikte sociale me banorët. Janë bërë disa përpjekje nga njerëzit për të marrë hak ndaj fabrikës (përfshi këtu prishjen e mureve, shpërthime) për arsye të ndryshme, një prej të cilave lidhet me pushimin nga puna të punonjësve, etj.

Ekziston një sindikatë, por ajo i shërben interesave të një grupi njerëzish, veçanërisht pronarëve të fabrikës, dhe jo të 300 punonjësve të saj. Edhe një nga anëtarët e sindikatës është pushuar nga puna.

Kryetari i bashkisë deklaroi se thuajse 3000 ton/ditë çimento transportohen falë 125 kamionëve që kalojnë në rrugët e Fushë-Krujës, duke shkaktuar kështu ndotje të mjedisit, dëmtime të rrugës, thyerja e kapakëve të pusëve, etc. Për sa i përket kësaj, kompania nuk mban asnjë përgjegjësi dhe i mbetet bashkisë të kujdeset për këto çështje.

Fabrika shkakton çdo ditë ndotje të ajrit duke qenë se ajo ndodhet vetëm 2-3 km larg qytetit.

Një çështje tjetër është *bypass*-i jofunksional (investim i ri prej 1.2 milion eurosh), duke qenë se mungon një rrethrotullim që të lidhë rrugën me *bypass*-in. Kjo çështje është nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Megjithatë, bashkia përfiton 20-25% të taksave që paguhet nga të ardhurat e kompanisë.

### **Bashkia e Bulqizës**

Për sa i takon vëzhgimeve të bëra nga kryetari i bashkisë, kompanitë që kryejnë aktivitetin e tyre në këtë zonë pretendojnë se kanë një Kod Sjelljeje, por kjo nuk ndahet me bashkinë, aktorët e interesuar apo me komunitetin.

Shpesh bashkia kërkon informacione të caktuara nga kompanitë, në rastin tonë nga *Albanian Chrome*. Megjithatë, nuk ekziston një kuadër ligjor që i detyron kompanitë të sigurojnë të gjitha të dhënat e kërkuara. Herë pas here kompania ofron informacion në varësi të bashkisë. E vetmja mënyrë për të marrë informacionin e kërkuar është përmes sindikatës. Sipas mendimit të bashkisë, sindikata është aktive. Ky konsiderohet si një ndryshim pozitiv, pavarësisht se bashkia nuk është ende plotësisht e kënaqur.

Disa kërkesa nga bashkia, përfshi këtu përmirësimin e kushteve të punës, zgjatja e jetëgjatësisë së minierave, nuk janë plotësuar nga kompania. Megjithatë, kohët e fundit kompania ka investuar në një pus të thellë dhe pritet të organizojë një aktivitet për të shënuar fillimin e investimeve.

Sipas mendimit të bashkisë, kompania duhet të bëjë më shumë përpjekje për të qenë më transparente. Nuk ka as informacion të mjaftueshëm të disponueshëm dhe nuk janë organizuar dëgjesa publike me komunitetin mbi çështjet që lidhen me CSR-në, si dhe veprime të tjera që ato ndërmarrin, të cilat mund të ndikojnë te mjedisi, komuniteti dhe punonjësit.

Në fund të vitit 2011, paga e 13-të nuk iu dha punonjësvë të kompanisë, gjë që shkaktoi disa protesta nga punonjësit.

*ACR*-ja ka kontribuar financiarisht për rindërtimin e katit të parë të pavionit patologjik për fëmijët në spitalin e Bulqizës. Për më tepër, ajo ka organizuar disa aktivitete argëtuese për fëmijët jetimë të minatorëve të vdekur.

### **5.2.3 Organizatat Joqeveritare**

#### **Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve**

Në kuadrin e projektit, në vitin 2010 u krijua një rrjet profesionistësh në fushën e burimeve të kromit, bakrit dhe naftës.

Sipas ligjit të vitit 2010 për Minierat, kompanitë duhet të përfshijnë brenda strategjisë së tyre: politika të CSR-së dhe politika mjedisore, që nuk paguajnë aktualisht rrogë minimale (sipas Kodit të Punës) dhe të marrin përsipër rehabilitimin e zonave të shfrytëzimit.

Gjithashtu, 25% e rentës minerare që kompanitë paguajnë në thesar (ose taksë dogane, e cila është 10%) sipas ligjit duhet t'u shkojë njërive të qeverisë vendore në zonën ku operojnë këto kompani (për shembull, Bashkia e Bulqizës duhet të përfitojë rreth 300,000 Euro/vit, por aktualisht ajo nuk përfiton asgjë).

Nuk ka transparencë sa i përket kontratave, prandaj bordi i AlBEITI-t i ka kërkuar qeverisë së Shqipërisë që të ndryshojë ligjin ekzistues Nr. 7746 për hidrokarburet, datë 28.07.1993.

Bankers Petroleum Albania Ltd, në burime sporadike ose në të ashtuquajturit «xhepa naftë» marrin përsipër nxjerrjen e naftës, pasi ky operacion është me kosto më të ulëta sesa teknologjia më e avancuar moderne. Kjo teknologji ka rezultuar problematike për zonën dhe si rezultat, në ndërtesat përreth ka pasur krisje dhe çarje të shkaktuara nga tërmetet artificiale. Komuniteti i fshatit Zharrëz tashmë ka protestuar, por në mënyrë spontane. Përveç kësaj, nxjerrja e naftës me shpërthim shkatërron burimin, pasi 30% e naftës humbet dhe burimi i naftës zhduket përgjithmonë.

### **Nisma për Transparencën e Industrive Nxjerrëse në Shqipëri (AlBEITI)**

AlBEITI është një ent publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, por nuk lidhet me politikën e Ministrisë. Ai bashkëfinancohet nga shteti dhe donatorët (shumica e financimit vjen nga Banka Botërore dhe nga Kanadaja).

Objektivat kryesorë të AlBEITI-t janë: a) transparenca b) publikimet dhe reklamat dhe c) kontaktet me komunitetin dhe njësitë e qeverisë vendore.

Ky ent është përgjegjës për hartimin e raporteve të pagesave në lidhje me ato pagesa që kompanitë e industrisë nxjerrëse deklarojnë në shtet dhe për rakordimin me shtetin në lidhje me gjendjen e pagesave që bëhen realisht. AlBEITI e publikon këtë raport.

Si tregues të performancës së tij shërbejnë njohja e kësaj nisme nga ana e komunitetit. Aktualisht, AlBEITI është në proces vlerësimi si kandidat për anëtar. Monitorimi dhe vlerësimi i këtij enti bëhet nga ekspertë të licencuar, të cilët hartojnë një raport vlerësimi.

AlBEITI harton planin e vet të punës, si dhe një strategji komunikimi dhe reklamimi. Komuniteti dhe shoqëria civile kanë të drejtë t'u kërkojnë informacion njërive të qeverisë vendore në lidhje me mënyrën se si shpenzohen fondet e marra nga kompanitë.

Për shembull, Bankers Petroleum Albania Ltd operon në një zonë të madhe që mbulon 7 komuna. Me ligj, kompania duhet t'i paguajë qeverisë vendore rreth 25% të tatimit të saj mbi të ardhurat (10%). Përmes raporteve të pagesave, si shteti, ashtu edhe komuniteti informohen për sasinë e parave të paguara për përfitimin e tyre, që tregojnë edhe ndikimin social të kompanisë. Deri tani, raportet e viteve 2009 dhe 2010 janë publikuar dhe janë vënë në dispozicion të publikut në faqen e AlBEITI-t: [www.albeiti.gov.al](http://www.albeiti.gov.al) ose [www.albeiti.org](http://www.albeiti.org)

Sipas ligjit në fuqi, kontratat e kompanive nuk mund të publikohen, duke mos lejuar kështu transparencën e tyre.

AlBEITI është mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri për të organizuar disa takime ndërgjegjësimi në Burrel, Bulqizë, Pogradec, Fier, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues të komunitetit, medias, shoqërisë civile, bizneseve dhe qeverisë vendore për të diskutuar ndikimin mjedisor dhe social në komunitet.

Pikat kryesore të raportit të vlerësimit të AlBEITI-t:

- Në sektorin e minierave, në vitin 2010 kanë raportuar një numër shumë më i madh kompanish sesa në vitin 2009 (60 në krahasim me 37). Kjo dëshmon për një njohje e respektim më të madh të rregullave të EITI-t në këtë sektor.

- Gjithashtu, kompanitë e minierave tani raportojnë edhe për ‘pagesa të tjera të konsiderueshme’, si edhe për pagesat që u bëjnë njësive të qeverisë vendore. Kjo do t’u sjellë një vlerë të shtuar njerëzve në rajonet prodhuese, pasi ata tani do të kenë të dhënat dhe mjetet për të ndjekur se çfarë ndodh me këto lloje fondesh.

- Në raportin e vitit 2009 thuhej se të ardhurat e shtetit qëndrojnë mbrapa asaj çka sektori po prodhon sa i përket rezultateve. E njëjta gjë vlen edhe për raportin e vitit 2010. Të ardhurat nga sektori i naftës janë rritur në krahasim me vitin 2009, por kjo ndodh kryesisht falë prodhimit më të madh në tërësi dhe çmimeve mesatare më të larta të naftës.

- Gjithashtu, ende duket sikur vlera e pjesës së prodhimit të AlbPetrol nuk arrin të gjejë rrugën për në buxhetin zyrtar. Kjo është arsyeja e një hendeku thelbësor midis shifrave të raportuara nga kompanitë dhe atyre të shtetit.

- Si një hap përpara, Sekretariati shqiptar i AlbEITI-t i ka kërkuar Sekretariatit Ndërkombëtar të AlbEITI-t që të përfundojë vlerësimin e tij, që mund të çonte në shpalljen e Shqipërisë si një vend që vepron në përputhje me AlbEITI-n në Konferencën Globale të EITI-t në Australi në muajin maj të këtij viti.

#### 5.2.4 Projektet e Donatorëve

PNUD-i ka qenë shumë aktiv që prej vitit 2008 sa i përket CSR-së si pjesë e Global Compact në Shqipëri. Forumi i tretë për CSR-në në Shqipëri u organizua më 17 dhjetor 2012. Gjatë forumit, u bë një prezantim mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për CSR-në dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2013. Në veçanti, hartimi i një fushate ndërgjegjësimi, ndërtimi i kapaciteteve të sektorit privat për CSR-në, përcaktimi i treguesve të performancës në shkallë kombëtare dhe shpërblimi i sipërmarrjeve të përgjegjshme u renditën si disa nga aktivitetet kryesore që PNUD-i do të mbështesë në vitin 2013. Përveç kësaj, përfaqësuesi i PNUD-it informoi mbi disa nisma të tjera që lidhen me CSR-në që po ndërmerren nga aktorë të ndryshëm si në nivel kombëtar, ashtu edhe atë rajonal. Të gjithë pjesëmarrësit u ftuan që t’i shprehnin vlerësimet e tyre PNUD-it ose METE-s në lidhje me aktivitetet e planifikuara.



## 6. PËRFUNDIM

Vihet re se pothuajse të gjitha kompanitë janë të përgjegjshme sa u takon tre shtyllave kryesore të politikës dhe veprimeve në fushën e CSR-së, si stafi/punonjësit, komuniteti/shoqëria dhe mjedisi. Disa prej kompanive janë më të ndjeshme ndaj disa fushave të caktuara në krahasim me disa të tjera, por në përgjithësi, ato të gjitha i trajtojnë çështjet e CSR-së.

Zakonisht, kompanitë kanadeze që operojnë në Shqipëri, kanë praktika të konsoliduara CSR-je në strategjitë e tyre të zhvillimit bazuar në praktikat më të mira të kompanive të tyre mëmë, si dhe në mjedisin miqësor që ka vendi ynë ndaj biznesit. Kjo është e vërtetë edhe në rastet kur kompanive nuk u është dhënë ende licenca e shfrytëzimit, si për shembull *Tirex Explorations Ltd*.

Pothuajse të gjitha kompanitë janë anëtare të shoqatave të ndryshme të biznesit që janë aktive në vend, kurse disa prej tyre (si Titan, Bankers, Devoll) janë anëtare aktive të forumit të CSR-së në Shqipëri.

Një nga mangësitë që u vu re nga kompanitë e intervistuar ishte e lidhur me faktin se zakonisht kompanitë nuk hartojnë dhe nuk publikojnë asnjë raport vjetor në lidhje me operimin e tyre dhe politikat e CSR-së që ato ndjekin.

Gjithashtu, kompanitë nuk kanë informacion të mjaftueshëm për nismat e qeverisë si Plani Kombëtar i Veprimit dhe treguesit e CSR-së që janë përcaktuar në të.

Më poshtë jepen disa nga përfundimet kyçe që dolën nga takimet me përfaqësues të bizneseve të ndryshme të ndara sipas fushave:

### a) Staf/Punonjësit

Të gjitha kompanitë e intervistuar veprojnë në përputhje me Kodin shqiptar të Punës, ato zakonisht lidhin kontrata individuale me punonjësit e tyre sipas parashikimeve të kodit të punës, përveç kontratave kolektive që nënshkruajnë me sindikatat përkatëse.

Sindikatat luajnë një rol të rëndësishëm dhe shërbejnë si moderatore midis drejtuesve të kompanive, qeverisë, komunitetit dhe punonjësve.

Janë vënë re disa raste, ku kompanitë përveçse përmbushin standardet e kërkuara të punës, kanë miratuar edhe kodet e tyre të brendshme të etikës.

Disa prej kompanive kanë ngritur edhe komisione të brendshme për punësimin e punonjësve.

Pothuajse të gjitha kompanitë kanë politikat e tyre të brendshme për krijimin e kushteve të kënaqshme të punës për stafin, si dollapë rrobash, dushe, dieta. Përveç kësaj, kompanitë kujdesen për shëndetin e punonjësve, duke i sponsorizuar ata për çdo problem shëndeti.

Vetëm një (*Titan Group*) nga tetë kompanitë e intervistuar ofron 24 orë mbështetje shëndetësore për stafin e vet në rast aksidentesh apo problemesh shëndetësore në punë, duke kontraktuar një mjek në ambientet e kompanisë.

Pothuajse të gjitha kompanitë e intervistuar kujdesen për të mësuarin e vazhdueshëm të punonjësve të tyre duke ofruar nivele të ndryshme trajnimi dhe kualifikime të mëtejshme

që nevojiten për punën. Vlen të përmendet rasti i *Titan Group*, i cili ka ngritur një Qendër të Akreditimit dhe Formimit Profesional.

### *b) Komuniteti*

Për të lehtësuar dialogun, si dhe për të ndërtuar e për të nxitur marrëdhënie të mira me komunitetin, disa kompani kanë krijuar një pozicion pune për marrëdhëniet me komunitetin.

Disa kompani zbatojnë strategjitë e tyre të komunikimit dhe si rezultat të gjithë aktorët e komunitetit informohen zakonisht për aktivitetet e kompanisë dhe hapat e reja që ata planifikojnë të ndërmarrin.

Kompanitë shpesh organizojnë takime me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin rreth CSR-së. Shembuj të tjerë janë edhe njoftimet në gazetata e përditshme ose numrat e telefonit ku komuniteti mund të informohet për projekte të ndryshme.

Të gjitha kompanitë e intervistuar nga të gjithë sektorët kanë kontribuar në mirëqenien e komunitetit në mënyrë të ndryshme, duke përfshirë:

- a. Ofrimin e sponsorizimeve si rikonstruktimin e spitaleve, urave, rrugëve, kanaleve të ujitjes, shkollave, klubeve sportive, mbjelljes së pemëve, kontrollit të zjarrit
- b. Organizimit të aktiviteteve si festa për Vitin e Ri për fëmijët
- c. Mbështetjen financiare të familjeve në nevojë apo në raste emergjencash
- d. Sipërmarrjen e studimeve për të mbështetur zbatimin e projekteve për komunitetet e tyre si pastrimin, furnizimin me ujë dhe energji elektrike
- e. Lehtësimin e transportimit të fëmijëve nga shtëpia në shkollë në zonat e largëta, ku mungon infrastruktura e nevojshme
- f. Subvencionimin e kostove të naftës ose ofrimin e buldozerëve të tyre për të hapur rrugët e bllokuara nga bora
- g. Financimin për bamirësi të kërkimeve dhe studimeve mbi kancerin
- h. Ndërhyrjet për riparimin e infrastrukturës së dëmtuar, si tubacionet e ujit.

### *c) Mjedisi*

Bazuar në legjislacionin për mjedisin, të gjitha industritë nxjerrëse janë të detyruara të kërkojnë dhe të pajisen me leje mjedisore me përmbushjen e standardeve dhe kërkesave përkatëse. Leja duhet të rinovohet çdo dy vjet. Për të përmbushur kriteret përkatëse të mjedisit, kompanitë ndërmarrin studime në fushën që ato operojnë për të identifikuar nivelin e ndotjes dhe për të hartuar plane zhvillimi.

Kompanitë monitorohen shpesh në çdo aspekt të ndikimit mjedisor nga agjencitë qeveritare si Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) ose AKBN. Ato i raportojnë çdo vit Ministrisë së Mjedisit një paketë minimale të dhënash.

Në disa raste, u vu re se kompanitë nuk kishin leje mjedisore apo standarde të tjera. Në një rast, një kompani kishte krijuar një komision sigurie në zyrën e sindikatave në fabrikë për të rishikuar dhe për të kontrolluar performancën e fabrikës.

Të pakta janë kompanitë që kanë bërë investime të mëtijshme për mbrojtjen e mjedisit duke investuar në filtra ajri dhe teknologji moderne.



*d) Bashkëpunimi me NjQV-të*

U vu re se në shumicën e rasteve kompanitë kanë bërë përpjekje për të ndërtuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme me njësitë përkatëse të qeverisë vendore, ku ata operojnë. Kjo i ndihmon ata që të bëhen më transparentë në nismat e tyre. Megjithatë, ka edhe raste kur komunikimi me qeverinë vendore mungon dhe ku nevojiten shumë përpjekje për të forcuar më tej komunikimin me pushtetin vendor.

*e) Problemet e hasura*

Disa kompani kanë shprehur shqetësimet e tyre sa i përket kostove të dyfishta që atyre u duhet të paguajnë për të riparuar dëmet e shkaktuara në të kaluarën (*madje që përpara se këto kompani të merrnin licencën apo të fillonin aktivitetin e tyre në vend*).

Përveç kësaj, në disa raste, kompanive u duhet të përballen me dëme (vendosje bombash në muret e fabrikave, trenave, ose bllokime të rrugëve) të shkaktuara nga keqbërës në zonat nxjerrëse dhe shfrytëzuese të kompanive.

Pronësia mbetet problematike në disa raste. Prandaj, kompanitë përpiqen të organizojnë takime me qytetarët, në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave të tyre dhe të zgjidhin problemet e ngritura.

Për shkak të situatës së vështirë financiare, kompanitë ndonjëherë nuk janë në gjendje t'u paguajnë punëtorëve pagën e 13<sup>te</sup>, e cila shkakton pakënaqësi dhe ndërprerje të punës.

Herë pas here, sidomos në sektorin e minierave, ka greva për shkak se punëtorët kërkojnë ngritje rrogash dhe kushte më të mira pune.

*f) Planet për të ardhmen*

Pothuajse të gjithë të intervistuarit ishin pozitivë për planet e tyre për të ardhmen, sidomos në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, si dhe hartimin e programeve për komunitetet, si zhvillimi i një bujqësie të qëndrueshme. Kompanitë u kushtojnë vëmendje sidomos rryllëzimit, energjisë së gjelbër dhe mbrojtjes e përdorimit me efikasitet të burimeve, si në rastin e menaxhimit të mbejtjeve.



## 7. REKOMANDIME

Duke i mëshuar rëndësisë së aplikimit të CSR-së dhe promovimit të saj nga kompanitë në Shqipëri, vetë industrinë nxjerrëse duhet të vazhdojnë të shkëmbejnë eksperiencat dhe punën e tyre për të bërë të njohura në vendet ku operojnë në Shqipëri praktikatat e mira që ato trashëgojnë nga kompanitë e tyre mëmë. Për bizneset në fushën e industrisë nxjerrëse, janë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme:

- Kompanitë duhet të hartojnë kodet e tyre të etikës sa i përket CSR-së, si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative
- Ato duhet të përqafojnë parimet dhe udhëzimet e OKB-së për investimet e përgjegjshme, si edhe ato të OECD-së për sipërmarrjet shumëkombëshe
- Bizneset në industrinë nxjerrëse duhet t'ia bëjnë të njohur komunitetit në zonat ku punojnë praktikatat e tyre të mira në fushën e CSR-së dhe të luajnë një rol aktiv mes aktorëve të tjerë të Forumit Kombëtar të CSR-së në Shqipëri
- Ato duhet të publikojnë dhe/ose përditësojnë rregullisht raportet vjetore dhe praktikatat e CSR-së nëse kanë projekte ose nisma të tilla për të ndarë me publikun
- Kompanitë duhet të vënë në zbatim standardet përkatëse të CSR-së, si për shembull SA 8000.

Kompanitë konkurrencte përbëjnë burimin e vetëm në shoqëri që gjeneron pasuri reale. Ato krijojnë pasuri duke konkurruar dhe duke bërë një biznes fitimprurës përmes klientëve që i shpërblejnë mirë. Në këtë kontekst, kompanitë nxjerrëse duhet të jenë më të përgjegjshme ndaj shtyllave kryesore të politikës dhe veprimeve CSR si: stafi/punonjësit, komuniteti/shoqëria dhe mjedisi.

Kështu, rekomandimet e mëposhtme i takojnë secilës prej kategorive të sipërpërmendura:

### *Stafi*

- Kompanitë duhet të vazhdojnë të përmirësojnë praktikatat e tyre të punës si një element i rëndësishëm i CSR-së
- Ato duhet të kujdesen që t'u sigurojnë programe të vazhdueshme trajnimi dhe kualifikimi punonjësve të tyre si një nga asetet e tyre më të çmuara
- Të përmirësojnë më tej kushtet e punës dhe të krijojnë hapësira për orare të përshtatshme pune dhe skema që krijojnë një lloj ekuilibri midis jetës dhe punës së punonjësve.

### *Komuniteti*

- Kompanitë duhet të nxisin dhe të përmirësojnë krijimin e një dialogu të përhershëm me komunitetin
- Ato duhet ta ndërjegjësojnë komunitetin për projektet e tyre, duke përdorur mjete të ndryshme, si media
- Bizneset duhet të jenë më proaktive dhe të marrin opinionin e komunitetit për nevojat e tyre

- Kompanitë duhet të vazhdojnë praktikatat e mira të sponsorizimit apo financimit të projekteve të komuniteteve.

#### *Mjedisi*

- Kompanitë duhet të zbatojnë standardet mjedisore
- Bizneset duhet të jenë të hapura ndaj kontrollit dhe mbikëqyrjes sa i përket përmbushjes së kriteve mjedisore
- Ato duhet të marrin përsipër më shumë nisma në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve.

#### *Bashkëpunimi me NJQV-të*

- Kompanitë duhet të jenë proaktive dhe të vazhdojnë të bashkëpunojnë me NJQV-të përkatëse dhe të ofrojnë zgjidhje për nevojat e komunitetit në kohën e duhur, pasi qytetarët janë të parët për nga rëndësia
- Bizneset duhet të lehtësojnë një bashkëpunim më të mirë dhe më të afërt mes sindikatave, kompanive dhe NJQV-ve.

Qeveria e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me programet e donatorëve si PNUD-i, duhet të përpiqet të bëjë të pamundurën për t'i mbështetur kompanitë (duke përfshirë edhe ato nxjerrëse) duke u kujdesur për sa më poshtë:

- Të bëjë të njohur Planin Kombëtar të Veprimt dhe treguesit e CSR-së
- Të nxisë politikatat e zhvillimit të CSR-së
- Të forcojë shërbimet e infrastrukturës për të lehtësuar praktikatat e CSR-së dhe reduktimin e kostove të të bërit biznes
- Të nxisë praktikatat e CSR-së mes industrive nxjerrëse dhe shpërndarjen e praktikave më të mira tek partnerët e tjerë
- Të nxisë dhe të ndihmojë bizneset për të arritur standardet e CSR-së dhe për të krijuar mundësi të tjera për të konkurruar
- Të nxisë projekte të reja të CSR-së për ndërtimin e një kuadri të qartë për kualifikimin dhe një mbështetje të institucionalizuar të kompanive nxjerrëse
- Të sigurojë transparencën e kontratave të hidrokarbureve
- Të vendosë para përgjegjësisë sektorin privat për krijimin e pasurisë dhe për shpërndarjen e saj në mënyrë të barabartë mes pronarëve dhe punonjësve.

## 8. SHTOJCA

### 8.1 PRAKTIKA MË E MIRË NË SHQIPËRI – RAST STUDIMI

#### 8.1.1 Titan Group

<b>Titulli: Shkolla Teknike Profesionale e Thumanës (Mekanikë)</b>	
<b>Ideja</b> <i>Cila ishte ideja e angazhimit tuaj në CSR?</i>	T'u ofronim të rinjve të kësaj zone trajnim dhe aftësi në mënyrë që ata të pajisen më mirë për tregun e punës.
<b>Qëllimi</b> <i>Cilat ishin qëllimet e kësaj sipërmarrjeje?</i>	T'u jepnim mundësi të rinjve të pajisen më mirë për këtë treg të vështirë pune. T'u jepnim mundësi të rinjve të shkolloheshin pa barrën financiare të transferimit në një vend tjetër. Përmirësimi i situatës ekonomike të të rinjve. Përmirësimi i standardit të jetesës së komunitetit.
<b>Motivimi</b> <i>Pse e ndërmoret këtë hap?</i>	Për të përmirësuar jetët e njerëzve/aktorëve të komunitetit ku operojmë.
<b>Njerëzit/partnerët që u përfshinë</b> <i>Kush mori pjesë?</i>	Komuna e Thumanës. Profesionistë/Mësues. Antea Cement sh.a.
<b>Hapat</b> <i>Çfarë hapash u ndërmoren?</i>	Ngritja e shkollës. Njoftimi i nxënësve. Dhurimi i pajisjeve laboratorike. Mbulimi i kostove.
<b>Rezultatet</b> <i>Cilat ishin rezultatet e këtyre hapave?</i>	Certifikimi i nxënësve Vazhdimi i trajnimit
<b>Përfitimet</b> <i>Cilat ishin përfitimet tuaja?</i>	Studentë të trajnuar të aftë e me dëshirën për të punuar. Fuqizimi i studentëve që vijnë nga grupe të caktuara vulnerabël. Përmirësimi i marrëdhënieve me komunitetin. Punëtorë të aftë potencialë për të ardhmen.
<b>Komunikimi</b> <i>Kë vutë në dijeni rreth hapave tuaj? Në ç'mënyrë?</i>	Komunën e Thumanës Komunitetin e Thumanës dhe gjithë zonën Punonjësit dhe partnerët. Investitorët. Qeverinë dhe OJG-të përmes prezantimit të veprimeve tona në seminare/aktivitete të ndryshme.
<b>Periudha kohore</b> <i>Sa kohë ju desh për këtë projekt?</i>	Projekti filloi në vitin 2010 dhe po vazhdon.
<b>Burimet</b> <i>Çfarë burimesh u siguruan?</i>	Mbështetje monetare. Mbështetje në natyrë për pajisjet laboratorike. Mbështetje për organizmin e shkollës.

## 8.1.2 Bankers Petroleum

<b>Titulli: Programi i Bankers në Mbështetje të Bujqësisë</b>	
<b>Ideja</b> <i>Cila ishte ideja e angazhimit tuaj në CSR?</i>	Rritja e të ardhurave e përafërsisht 80% të familjeve të prekura nga aktiviteti i kompanisë nëpërmjet marrjes përsipër të një programi shumëvjeçar për përmirësimin e praktikave bujqësore, prodhimit, aksesit në tregje dhe komercializimit në përgjithësi të bujqësisë.
<b>Qëllimi</b> <i>Cilat ishin qëllimet e kësaj sipërmarrjeje?</i>	T'u përgjigjeshim nevojave të shprehura të fermerëve nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm të aktorëve të interesuar.  T'u ofronim fermerëve përmes trajnimit njohuri dhe mjetet e nevojshme për të bërë ndryshime.  Përmes asistencës së ofruar në fermat bujqësore prej disa nga ekspertëve më të mirë të bujqësisë në Shqipëri, të mbështesim fermerët për t'u modernizuar, për të hartuar plane biznesi dhe për të pasur mundësi për të marrë kredi.
<b>Motivimi</b> <i>Pse e ndërmoret këtë hap?</i>	Të përmirësonim të ardhurat e 80% të popullsisë të familjeve të prekura nga aktiviteti i kompanisë.  Të përmirësonim marrëdhënien tonë si korporatë me aktorët e interesuar.  Të përmirësonim “licencën tonë sociale” për të operuar”.
<b>Njerëzit/partnerët që u përfshinë</b> <i>Kush mori pjesë?</i>	ARM Fier.  Drejtoria e Bujqësisë.  Drejtuesit dhe specialistët e komunës.  Ekspertë shqiptarë të bujqësisë të përfshirë në Projektin e USAID-t për Konkurrueshmërinë e Bujqësisë Shqiptare  Folës të ftuar.  Tregtarë që kanë akses në tregje ndërkombëtare.

<p><b>Hapat</b></p> <p>Çfarë hapash u ndërmorën?</p>	<p>Një studim ekonomik për të kuptuar nevojat dhe rrethanat e aktorëve të interesuar.</p> <p>Zbatimi i një programi 4-mujor trajnimi dhe asistence (mentorimi) për fermerët, duke përfshirë edhe vizita në vende ku ka pasur histori suksesi; trajnime të zhvilluara nga ekspertë dhe mentorë në feramat bujqësore.</p> <p>Studim fizibiliteti për ujitjen dhe kullimin, duke përfshirë mobilizimin e fermerëve për të marrë përsipër përgjegjësi në pastrimin e kanaleve të tyre dhe në shlyerjen e kostove të operimit të pompave që do të financohen nga Bankers.</p> <p>Mbështetja e fermerëve për të pasur akses në kredi për të vënë në jetë ndryshimet e nevojshme.</p> <p>Identifikimi i qartë i tregjeve (të eksportit) dhe lidhja e këtyre tregjeve me fermerët tanë, sipas metodës së “grupimeve” (cluster).</p>
<p><b>Rezultatet</b></p> <p>Cilat ishin rezultatet e këtyre hapave?</p>	<p>Rezultatet do të jenë më të qarta në vitin 2013. Megjithatë, ka pasur një pjesëmarrje shumë të mirë të fermerëve në trajnime dhe një dëshirë të madhe të shprehur nga fermerët për të marrë pjesë në ujitjen, kullimin dhe rritjen e kulturave për eksport sipas modelit të “grupimit”, qofshin këto kultura në fushë të hapur, qoftë në serra.</p>
<p><b>Përfitimet</b></p> <p>Cilat ishin përfitimet tuaja?</p>	<p>Nuk ka përgjigje nga kompania.</p>
<p><b>Komunikimi</b></p> <p>Kë vutë në dijeni rreth hapave tuaj? Në ç'mënyrë?</p>	<p>Kemi bërë njoftime për trajnimet në televizionet lokale, përmes agronomëve të komunës, duke kontaktuar me fermerët (me telefon, mesazhe telefonike) dhe postera.</p> <p>Po planifikojmë edhe një komunikim më të formalizuar dhe një proces promovimi, por janë ende në proces.</p>
<p><b>Periudha kohore</b></p> <p>Sa kohë ju desh për këtë projekt?</p>	<p>Të gjitha aspektet, duke filluar nga studimi, kanë zgjatur 1 vit dhe do të vazhdojnë për shumë vjet.</p>
<p><b>Burimet</b></p> <p>Çfarë burimesh u siguruan?</p>	<p>Bankers ka ofruar burime të konsiderueshme financiare dhe njerëzore për sipërmarrjen e këtij projekti.</p>

## 8.2 FORMULARI I PYETËSORIT PËR BIZNESET

<b>Fusha e CSR-së: Njerëzit (I)</b>			
1	A ka hartuar kompania juaj një kod të brendshëm sjelljeje që njihet nga gjithë punonjësit dhe aktorët e interesuar të kompanisë suaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
2	A i keni të kufizuara mirë vlerat e korporatës suaj dhe a i komunikohen ato vazhdimisht punonjësve dhe aktorëve të tjerë të interesuar?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
3	A siguroheni që produktet dhe shërbimet tuaja të mos shkaktojnë asnjë rrezik për konsumatorët dhe klientët tuaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
4	A janë të drejta dhe transparente pagesat që ju u bëni punonjësve tuaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
5	A kujdeseni për zhvillimin e personelit (p.sh. me trajnime, intervista vlerësimi)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
6	A u ofroni zgjidhje punonjësve tuaj për t'i mbështetur ata në arritjen e ekuilibrit punë-jetë (p.sh. orare fleksibël pune, mundësi për të punuar nga shtëpia)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	Jo
7	A praktikoni një dialog të vazhdueshëm me stafin dhe a i përfshini punonjësit tuaj në marrjen e vendimeve të rëndësishme?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
8	A bashkëpunon kompania juaj me 'komitetet dhe sindikatat e punëtorëve'?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
9	A punon kompania juaj me partnerë (OJQ, bashki, etj.) për të gjetur zgjidhje për probleme specifike?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

<b>Fusha e CSR-së: Mjedisi (III)/ Seksioni A</b>			
10	A është ZGJIDHJA e problemeve mjedisore pjesë e strategjisë së kompanisë suaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo



11	Gjatë projektimit dhe lançimit të një produkti, a merrni ju në konsideratë aspektet mjedisore, si konsumimi i energjisë, asgjësimi i mbetjeve, parandalimi dhe riciklimi i mbetjeve?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
12	A keni ngritur ndonjë sistem për menaxhimin e mjedisit, që përmbush standardet e gjithëpranuara (p.sh. ISO 14001, EMAS)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
13	A merrni masa për ruajtjen e energjisë?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
14	A merr masa kompania juaj për shmangien e mbetjeve?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
15	A përdorni materiale të riciklueshme dhe/ose teknika ricikluese?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
16	A merrni masa për mbrojtjen e natyrës?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
18	A përdorni rrugë dhe mjete të arsyeshme transporti (p.sh. që prodhojnë më pak CO <sub>2</sub> )?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
18	A trajtohen me transparencë risqet mjedisore të shkaktuara nga kompania?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
19	A bashkëpunoni me autoritetet publike, institucionet shkencore dhe OJQ-të për mbrojtjen e mjedisit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

## Seksioni B

20	A aplikohet ndonjë sistem për menaxhimin e cilësisë në kompaninë tuaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
21	A kanë produktet tuaja etiketa cilësie dhe/ose certifikata sigurie?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
22	A keni një sistem për menaxhimin e vërejtjeve dhe ankesave për klientët dhe partnerët tuaj të biznesit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
23	A i kushtoni vëmendje reklamimit në mënyrë etike?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

24	A bashkëpunoni me kompani dhe organizata të tjera për ta kthyer CSR-në në objekt diskutimi?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
----	---	--	-----------------------------

**Fusha e CSR-së: Komuniteti / Shoqëria (IV) / Seksioni A**

25	A jeni të përfshirë në krijimin e kushteve të përgjithshme dhe të një kuadri ligjor më të mirë në komunitetin dhe vendin tuaj (p.sh. në arsim, cilësinë e jetës, infrastrukturë, sport dhe kulturë)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
26	A praktikoni një dialog të vazhdueshëm me njësitë e pushtetit vendor dhe OJQ-të në lidhje me problemet më të rëndësishme të komunitetit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
27	A e dinë punonjësit, klientët dhe aktorë të tjerë të interesuar se ju angazhoheni në një projekt të caktuar CSR dhe çfarë përfitimesh presin ata nga përfshirja juaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
28	A jeni të sigurt se një projekt CSR që ju zhvilloni do t'i sjellë përfitime sipërmarrjes suaj?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
29	A mundet një projekt CSR të përmirësojë situatën individuale të njerëzve që ai synon të ndihmojë?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

**Fusha e CSR-së: Komuniteti / Shoqëria (Informimi i Publikut) Seksioni B**

29	A publikoni rregullisht raporte biznesi cilësore?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
30	A është i besueshëm dhe i bazuar në fakte dhe shifra informacioni që ju publikoni?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
31	A u jepni aktorëve të interesuar në aktivitetin tuaj të dhëna kyçe si fitimi mbi kapitalin, të ardhurat neto, të ardhurat bruto?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
32	A praktikoni një mbajtje etike të të dhënave të kompanisë në përputhje me standardet ndërkombëtare?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
33	A janë transparente pagat dhe shpërblimet (duke përfshirë edhe pagat e drejtuesve të lartë)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
34	A merret kompania me çështje shumë të rëndësishme (si risqet, ndotja e shkaktuar nga vetë kompania juaj)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

35	A praktikoni një dialog të hapur me të gjithë aktorët?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo
36	A janë të përcaktuara qartë vlerat e korporatës suaj dhe të njohura mirë nga punonjësit, klientët tuaj dhe aktorë të tjerë të interesuar?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> me kufizime	<input type="checkbox"/> Jo

### 8.3 PYETJE ORIENTUESE PËR QEVERINË QENDRORE DHE NJËSITË E QEVERISË VENDORE

9. Si ka punuar qeveria për të krijuar mjedisin më të mirë të mundshëm që përgjegjësia sociale e korporatave të ngulitet në praktikat e kompanive?
10. A ka pasur konsultime, dhe nëse ka qenë e mundur, a është arritur ndonjë konsensus me bizneset dhe aktorë të tjerë të interesuar në lidhje me CSR-në dhe vlerat e korporatës?
11. Nëse po, në ç'mënyrë e praktikoni dialogun me bizneset dhe aktorë të tjerë të interesuar?
12. A po punon qeveria për të përcaktuar treguesit e vlerësimit të nivelit të CSR-së brenda kompanive, brenda sektorëve dhe në gjithë vendin?
13. Nëse po, a i ka përshtirë qeveria edhe industrinë nxjerrëse si sektorin e naftës dhe të gazit, sektorin e minierave, sektorin e prodhimit të çimentos dhe hidrocentralet sa i përket CSR-së?
14. A mendoni se një fokusim më i thellë në aspektet e CSR-së në sektorët e sipërpërmendur mund të jetë i vlefshëm për krijimin e avantazheve konkurruese nga ana e Shqipërisë?
15. A i konsideron qeveria 'komitetet dhe sindikatat e punëtorëve' aktorë të rëndësishëm për CSR?
16. Në Shqipëri ekziston një Plan Kombëtar Veprimi për të promovuar përgjegjësinë sociale të korporatave. Ku qëndron ky plan dhe/ose sa progres është arritur deri tani në zbatimin e tij?
17. A është krijuar ndonjë lloj nxitjeje apo stimuli për kompanitë që punësojnë njerëz që u përkasin grupeve më pak të avantazuara?
18. A ekziston ndonjë sistem i planifikuar për t'i dhënë grante bizneseve të vogla dhe të mesme që fusin programe CSR në mënyrë individuale ose në rrjet ose në grup me biznese të tjera?
19. Cila është marrëdhënia midis Ministrisë/NjQV-së suaj me biznesin përkatës sa i përket CSR-së?

## 8.4 FOTO NGA KOMPANITË E INTERVISTUARA

### *Tirex Explorations Ltd*



### *Albanian Chrome*



### *Stream Oil & Gas Ltd*





*Antea Cement sh.a – Titan Group*



*Energy Ashtashpk*



## 8.5 BIBLIOGRAFIA

- Matja e CSR-së në Shqipëri, Treguesit për Matjen Kombëtare dhe Sektoriale të CSR-së, Raport i PNUD-it 2012
- Përgjegjësia Sociale e Korporatave në Shqipëri – një politikë për Qeverinë e Shqipërisë, METE-n, përgatitur nga Dr. Paul Stubbs, Instituti i Ekonomikut, Zagreb, Kroaci, Maj 2011
- Krijimi i CSR-së në Europën Jug Lindore, Çmimi CSR për vitin 2007, Manuali i Jurisë, ILTIS GmbH
- Raporti i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Ministria e Punës, 2012
- Forumi Botëror Ekonomik, 2010
- Raporti i Indeksit të Performancës Mjedisore I 2010
- Një strategji e re e BE-së 2011-2014 për CSR-në, Bruksel, 25.11.2011
- Parimet dhe Standardet Kryesore Ndërkombëtare për CSR, Christina Dinca, Shefe e Departamentit të Certifikimit EMS, RinaSimtex
- Prezantimi i Antea Cement sha për CSR-në dhe Praktikën Laboratorike, 17 dhjetor 2012
- Kodi CG për kompanitë e palistuar, IFC 2011
- Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për CSR-në, METE
- Kodi i qeverisjes së korporatave për kompanitë e palistuar, METE
- Shënime nga takimi i forumit të PNUD-it për CSR-në
- VKM Nr. 47, datë 16.01.2008 për programet e nxitjes së punësimit përmes trajnimit në vendin e punës
- VKM Nr. 48, datë 16.01.2008 për programet e nxitjes së punësimit përmes punëkërkesve të papunë në vështirësi
- VKM Nr. 873, datë 27.12.2006 për masën e financimit, kritereve dhe procedurave të zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë që kanë një diplomë universitare
- Ligji Nr. 7746, datë 28.07.1993 për hidrokarburet (kërkim dhe prodhim nafte)
- Broshurat e Hidrocentralit të Devollit (Devoll Hydropower shpk)
- Broshurat e Hidrocentralit të Ashtës (Energy Ashtashpk)

[www.csr-see.com](http://www.csr-see.com)

[www.see-network.com](http://www.see-network.com)

[www.shkp.gov.al](http://www.shkp.gov.al)

[www.mete.gov.al](http://www.mete.gov.al)

[www.albeiti.gov.al](http://www.albeiti.gov.al)

[www.sli.gov.al](http://www.sli.gov.al)